



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Zyra e Kryeministrit / Kancelarija Premijera /
Office of the Prime Minister*

*Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje /
Office of Good Governance*

**STRATEGJIA PËR
AVANCIMIN E TË
DREJTAVE TË
KOMUNITETEVE ROM
DHE ASHKALI
NË REPUBLIKËN E
KOSOVËS 2022-2026
DHE PLANI I VEPRIMIT
2022-2024**

Korrik 2022

Ky publikim është mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit / Kancelarija Premijera / Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarja za Dobro Upravljanje / Office of Good Governance

**STRATEGJIA PËR AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË
KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS 2022-2026
DHE PLANI I VEPRIMIT 2022-2024**

Korrik 2022

Publikimi realizohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe kundër Diskriminimi e mbështetur nga OSBE-ja

PËRMBAJTJA

LISTA E TERMAVE DHE SHKURTESAVE TË PËRDORURA	4
PËRMbledhje Ekzekutive	5
HYRJE	8
METODOLOGJIA	9
I. SFONDI	12
1.2. Baza ligjore dhe strategjike	16
1.3. Mekanizmat për mbrojtjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë	21
II. OBJEKTIVAT	23
2.1. Arsimi	27
2.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale	36
2.3. Shëndetësia	48
2.4. Banimi	52
2.5. Diskriminimi	56
III. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT TË STRATEGJISË 60	
IV. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISË	69
V. NDËRLIDHJA E STRATEGJISË ME QËLLIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM 72	
PLANI I VEPRIMIT 2022-2024	Error! Bookmark not defined.5

LISTA E TERMAVE DHE SHKURTESAVE TË PËRDORURA

AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
AGTSH (MICS)	Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (e njohur botërisht si MICS)
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
Kushtetuta	Kushtetuta e Republikës së Kosovës
Korniza e BE-së për Integrimin e Romëve	Korniza e Bashkimit Evropian për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve deri në vitin 2020-2030, Bruksel, 07.10.2020, COM (2020)
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OZhQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
PK	Policia e Kosovës
PLV	Plani Lokal i Veprimit
Programi i Qeverisë	Programi Qeverisës së Republikës së Kosovës 2021–2025, maj 2021
Qeveria	Qeveria e Republikës së Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
Strategjia	Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Plani i veprimit 2022-2024.
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
ZÇK	Zyra për Çështjet e Komuniteteve
ZKKK	Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të ZKM

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës, më 17 shkurt 2008, institucionet e Republikës së Kosovës, përveç shumë iniciativave dhe aktiviteteve të ndryshme, kanë hartuar dy (2) strategji për integrimin dhe përfshirjen e romëve, ashkalive dhe egjiptiane në shoqërinë kosovare.¹ Republika e Kosovës, gjithashtu ka marrë pjesë aktive në nismat e BE-së dhe rajonale që synonin përmirësimin e jetës së komuniteteve Rom dhe Ashkali. Në këtë drejtim vlen të ceket Samiti i vendeve të Ballkanit Perëndimor, i cili u mbajt në korrik të vitit 2019 në Poznan (Poloni). Kosova, ishte pjesë e këtij samiti ku u zotua të mbështes integrimin e romëve duke nënshkruar, sikurse edhe vendet tjera, "Deklaratën e vendeve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e Romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian."²

Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Plani i veprimit 2022-2024 paraqet një vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërtimin e një shoqërie shumetnike dhe krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve.

Në bazë të Kornizës BE-së për Integrimin e Romëve, janë definuar pesë fusha të veprimit të cilat adresohen në Strategji: arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi dhe diskriminimi. Këto fusha paraqesin prioritetet me të cilat duhet të ballafaqohet zbatimi i Strategjisë, dhe ndërveprojnë me njëra tjetrën. Në shumicën e rasteve paraqesin edhe shkaqe edhe rrjedhoja apo efekte të njëra-tjetrës, prandaj është jetike të punohet në secilën në mënyrë që të arrihen rezultate efektive. Për secilën nga pesë fushat e Strategjisë është definuar një objektiv strategjik. Secili objektiv strategjik është zbrëthyer në objektiva specifike, ndërsa këto objektiva specifike më tutje në Planin e Veprimit janë zbrëthyer në rezultate dhe në aktivitete.

¹ Strategjia për përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021, si dhe Strategjia për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009- 2015.

² Deklarata e partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e Romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian, Poznan, 5 korrik 2019. Me këtë dokument vendet nënshkruese zotohen për arritjen e objektivave të mëposhtëm: a. Punësimi: Rritja e shkallës së punësimit të romëve në sektorin publik në shkallë proporcionale të pjesëmarrjes së romëve në popullatën e përgjithshme; Rritja e shkallës së punësimit të romëve në të paktën 25 përqind; b. Strehimi: Kudo që të jetë e mundur, të legalizohen të gjitha vendbanimet joformale ku jetojnë Romët; ose të sigurohet strehim i përhershëm, i denjë, përballueshëm dhe i dekretuar për romët që aktualisht jetojnë në vendbanime joformale që nuk mund të legalizohen për arsye të justifikuara; c. Arsimi: Rritja e regjistrimit dhe e shkallës së përfundimit në arsimin fillor tek romët në 90 përqind dhe shkalla e regjistrimit dhe përfundimit në arsimin e mesëm në 50 përqind; d. Shëndeti: Garantimi i mbulimit universal të sigurimit shëndetësor për romët të paktën 95 përqind ose në masën e barabartë me pjesën tjetër të popullatës; e. Regjistrimi civil: Sigurim që të gjithë romët të jenë regjistruar në regjistrat civilë; f. Mosdiskriminimi: Forcimi i strukturave të qeverisë për mbrojtjen kundër diskriminimit dhe krijimit të një nën-ndarje specifike për mosdiskriminimin e romëve brenda organeve zyrtare të mosdiskriminimit për të proceduar ankesat nga romët, sigurimi për mbështetje ligjore për viktimat e pretenduara dhe për të identifikuar skemat e diskriminimit, përfshirë diskriminim institucional dhe të fshehur.

Përmbushja e këtyre objektivave do të kontribuojnë edhe në arritjen e synimeve nacionale të përcaktuara sipas Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).³

Në vijim po japim një përmbledhje të shkurtër të sfidave sipas këtyre fushave, të cilat janë të bazuara në gjetjet e raporteve të fundit nacionale mbi cilësinë e jetës në fusha të ndryshme, siç është edicioni i fundit i Raportit Përfundimtar të Anketës së Grupimeve me Tregues të Shumëfishtë të Kosovës (MICS), publikuar në fund të vitit 2020, si dhe raporte të tjera të ngjashme me të dhëna për qytetarët e Kosovës dhe në veçanti për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali, sikur ato të publikuara nga UNDP dhe OSBE:

Arsimi: Me gjithë progresin në rritjen e pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve nga radhët e komuniteteve Rom dhe Ashkali dallimi me mesataren e Kosovës vazhdon të jetë domethënës. Po ashtu, fëmijët nga radhët e komuniteteve Rom dhe Ashkali tregojnë performancë më të dobët në shkollë sesa mesatarja në Kosovë. Një shkallë e lartë e mungesës së ndërgjegjësimit për rëndësinë e shkollimit vërehet edhe tek pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali, por shpesh mungon edhe ndërgjegjësimi i shumicës për rëndësinë shoqërore të shkollimit të këtyre komuniteteve. Përveç ndërgjegjësimit për rëndësinë e shkollimit, problematikat me shkallën e ulët të arsimimit janë edhe rrjedhojë e varfërisë, papunësisë kushteve dhe standardit të ulët të jetesës, pjesëmarrjes së ulët në edukimin parashkollor. Në këtë drejtim, një numër i konsiderueshëm i familjeve dhe fëmijëve nga radhët e komuniteteve Rom dhe Ashkali, detyrohen të gjejnë alternativa të tjera për të siguruar jetesën. Një numër i madh i fëmijëve të këtyre komuniteteve gjenden në situatë rruge, duke kryer punë të ndryshme, si kërkim lëmoshe, pastrimin e xhamave të veturave, mbledhjen e kanaqeve, etj. Për shkak të këtyre punëve, një pjesë e tyre e braktisin shkollimin në fëmijëri të hershme, dhe si rrjedhojë e drejta e tyre për shkollim nuk mund të ushtrohet në mënyrë të efektshme.

Punësimi dhe mirëqenia sociale: Gjendja e punësimit për personat që i përkasin komuniteteve Rom dhe Ashkali është më e vështirë në krahasim me komunitetet tjera, ndërsa vendet e punës në të cilat janë të angazhuar janë shpesh të përkohshme, të shumtën fizike, që nuk kërkojnë shkathtësi të larta dhe nuk paguhen mirë. Kur kësaj i shtohet përfshirja e ulët e komuniteteve në skemat e mirëqenies sociale dhe shfrytëzimi i pamjaftueshëm i shërbimeve sociale del se zbutja e varfërisë në mesin e komuniteteve Rom dhe Ashkali paraqitet si sfida shumë serioze. Papunësia dhe varfëria janë nga faktorët kryesorë që kanë efekte të shumëfishta në jetën e komuniteteve Rom dhe Ashkali,

³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 25 janar 2018, ka nxjerrë Rezolutën (Nr.06-R-001) për miratimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (ose Agjenda 2030). Në vitin 2015, liderët botërorë miratuan Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, duke premtuar eliminimin e varfërisë së skajshme, uljen e pabarazisë dhe krijimin e një planeti më të gjelbër. Duke premtuar të mos lëmë askënd pas, Agjenda 2030 është agjenda jonë më e guximshme për njerëzimin. Agjenda 2030 përfshin 17 Synime Globale të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-të). Ato janë të ndërlidhura, universale, gjithëpërfshirëse dhe të pandashme, dhe promovojnë të drejtat e njeriut dhe qëndrueshmërinë ekonomike, sociale dhe mjedisore: ne duhet t'i arrijmë të gjitha këto qëllimet për të ndërtuar të ardhmen që duam. Në nivel global, 17 OZhQ-të ofrojnë udhëzime të qarta për 169 caqe që duhen miratuar në përputhje me prioritetet lokale dhe me sfidat mjedisore të botës në përgjithësi. Qeveritë do të zhvillojnë edhe treguesit e tyre kombëtarë për të ndihmuar në monitorimin e përparimit të arritur ndaj synimeve dhe caqeve. <https://assembly-kosova.org/shq/per-publikun/zhvillimi-i-qendrueshem/objektivat-per-zhvillim-te-qendrueshem/>

ku paraqiten edhe si shkak edhe si rrjedhojë. Rrjedhojat apo efektet që dalin nga papunësia dhe varfëria reflektohen në pothuajse të gjitha fushat e tjera të prioriteteve: arsim, shëndetësi, banim. Mirëpo papunësia dhe varfëria kanë për shkak në masë të madhe diskriminimin, e pjesërisht edhe nivelin e ulët të arsimimit të komuniteteve Rom dhe Ashkali.

Shëndetësia: Me një qasje të kufizuar në shërbimet parandaluese dhe kurative shëndetësore, pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali vazhdojnë të vuajnë nga shëndeti i dobët. Ndër pengesat kryesore për qasje në shërbime shëndetësore janë: varfëria dhe pamundësia për pagesën e trajtimit dhe blerjes së barnave, mungesa e stafit mjekësor dhe ekipeve mobile, mungesa e transportit publik, si dhe mungesa e dokumenteve të identifikimit që nevojiten për të pranuar shërbime publike të shëndetit dhe regjistrimit të lindjeve. Komunitetet Rom dhe Ashkali vuajnë nga një prevalencë e lartë e të ushqyerit joadekuat dhe të pamjaftueshëm si rezultat i kushteve ekonomike jo të mira, gjë që kontribuon në shëndetin e dobët dhe jetëgjatësinë e shkurtër. Niveli i sëmundshmërisë është brengosës, veçanërisht prezenca e sëmundjeve kronike jo të transmetuese, si të diabetit, hipertensionit, sëmundjeve kardiovaskulare dhe çrregullimeve të skeletit.

Banimi: Një sfidë e madhe për zgjidhjen e problemit të banimit është evidentimi i nevojave të familjeve të komuniteteve Rom dhe Ashkali. Nevoja për sigurimin e banimit vazhdon të jetë shumë më e madhe sesa mundësitë buxhetore, prandaj është e domosdoshme të përcaktohen prioritetet me rastin e ofrimit të ndihmës. Ky problem duhet të adresohet në kuadër të procesit të regjistrimit të bazës së të dhënave për nevojat e banimit nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), sipas nevojave dhe prioriteteve. Po ashtu, duhet siguruar një shkallë më të lartë të përfshirjes së vet pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali në zgjidhjen e problemit të banimit, duke filluar nga kërkesat e nevojave për banim, e deri tek rregullimi i dokumentacionit pronësor.

Diskriminimi: Diskriminimi është prezent në gjithë popullatën, sidomos në aspektin gjinorë, po edhe numri i romëve dhe ashkalive, që në situatë shoqërore ndihen të diskriminuar për shkak të përkatësisë së tyre etnike është më shumë prezent, sesa tek pjesa tjetër e popullsisë, prandaj ky fenomen kërkon trajtim më afatgjatë. Korniza e BE-së për Integrimin e Romëve, në të cilën bazohet edhe kjo Strategji, përkufizon luftimin e diskriminimit si: luftimin e diskriminimit, ngacmimit, krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes kundër romëve (lexo: dhe ashkalive); promovimin (ndërgjegjësimin) e historisë, kulturës, njohjes dhe pajtimit të romëve (lexo: dhe ashkalive). Diskriminimi, është një fenomen që është prezent në fushën e arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë, dhe banimit, ku do të trajtohet në këto katër fushat, duke vendosur objektiva specifike të veçanta që i dedikohen diskriminimit.

HYRJE

Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Plani i veprimit 2022-2024 është paraparë në Programin e Qeverisë⁴ dhe në Planin Strategjik Operativ (PSO) të Zyrës së Kryeministrit.

Gjatë hartimit të Strategjisë janë marrë parasysh mësimet e nxjerra nga raporti i zbatimit të Strategjive paraprake për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë,⁵ Korniza e BE-së për Integrimin e Romëve,⁶ Programi i Qeverisë, Anketat e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë, për komunitetet Rom dhe Ashkali në Kosovë, të realizuar në 2019-2020 nga ASK,⁷ si dhe legjislacioni dhe dokumentet dhe strategjitë tjera sektoriale.

Zyra për Qeverisje të Mirë ka udhëhequr edhe hartimin e Strategjisë së parë në vitin 2008,⁸ dhe Strategjisë së dytë në vitin 2017,⁹ edhe kjo Strategji paraqet një vazhdimësi të politikave të Qeverisë për ndërtimin e një shoqërie shumetnike dhe krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë. Në kuadër të procesit të hartimit të kësaj strategjie janë marrë mësimet nga dy strategjitë, paraprake 2009-2015 dhe ajo 2017-2021, si dhe planet e veprimit për zbatimin e tyre.

Romët dhe ashkalitë e Kosovës janë komunitete të veçanta të cilët jetojnë tradicionalisht në Kosovë dhe kanë dhënë kontribut thelbësor në shoqërinë e larmishme të saj me traditat dhe kulturat e tyre të dalluara.¹⁰ Këto komunitete, krahas komuniteteve tjera, gëzojnë të drejta të përcaktuara me Kushtetutë dhe me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, këto komunitete përballen me pengesa dhe sfida të ngjashme, në kuptim të përfshirjes së tyre në shoqëri. Romët dhe ashkalitë e Kosovës përballen me një problem të njëjtë në të gjitha vendet e Evropës, e ky është përjashtimi shoqëror. “Zakonisht, ky lloj përjashtimi manifestohet në formë të jetës në varfëri, segregacionit, qasjes së

⁴ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021–2025, maj 2021.

⁵ Strategjia për përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2017-2021, Qeveria e Republikës së Kosovës, Zyra e Kryeministrit-Zyra për Qeverisje të Mirë, Prishtinë, Prill 2017 (Në tekstin e mëtejme: Strategjia për përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2017-2021) si dhe Strategjia për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009- 2015, Qeveria e Republikës së Kosovës, Zyra e Kryeministrit-Zyra për Qeverisje të Mirë, Prishtinë, Dhjetor 2008 (Në tekstin e mëtejme: Strategjia për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009- 2015). Siç vërehet në Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës të miratuar në dhjetor të vitit 2008, kanë qenë të përfshirë edhe komuniteti Egjiptianë, më pastaj përfaqësuesit e komunitetit egjiptianë nuk kanë dëshiruar që të jenë pjesë e kësaj strategjie. Duke respektuar vullnetin e përfaqësuesve të këtyre komuniteteve, që nga Strategjia e Qeverisë së Republikës së Kosovës e miratuar në prill të vitit 2017, komuniteti egjiptian nuk janë përfshirë në Strategji duke përfshirë edhe këtë Strategji. Romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës janë tri komunitete të veçanta. Megjithatë, të tri këto komunitete përballen me pengesa dhe sfida të ngjashme, në kuptim të përfshirjes së tyre në shoqëri. Të vetëdijshëm që në shumë situata, komuniteti egjiptianë përballen me problemet dhe sfidat e komuniteteve Rom dhe Ashkali, dhe duke marrë parasysh që jo rrallë është shumë e vështirë që të bëhet një ndarje të problemeve dhe sfidave të këtyre tri komuniteteve, megjithatë është respektuar vullneti përfaqësuesve të komunitetit egjiptianë dhe fokus i kësaj strategjie janë komunitete Rom dhe Ashkali.

⁶ Korniza e BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve deri në vitin 2020-2030, Bruksel, 07.10.2020, COM (2020) 620. Në kontekstin Kosovar, në kuadër të termit të gjerë gjithëpërfshirës "Roma", sipas Kornizës së BE-së për Integrimin e Romëve, këtu përfshihen romët, ashkalitë dhe egjiptianët.

⁷ MICS për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ASK, 2020.

⁸ Strategjia për Integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015.

⁹ Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021.

¹⁰ Shih Pasqyrë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, OSBE, janar 2020, fq. 4.

vështirësuar në shërbime sociale, diskriminimit, e të ngjashme. Edhe Rajoni i Ballkanit Perëndimor përballet me situata të ngjashme që, në kushte të ngecjes në zhvillim ekonomik, e bëjnë gjendjen e romëve edhe më të vështirë.”¹¹

Si rrjedhojë, shumica e anëtarëve të këtyre komuniteteve “...jetojnë në margjina të shoqërisë, në përpjekje me nivele të larta të papunësisë dhe arritje të ulët arsimore. Shpeshherë jetojnë në vendbanime të cilat janë në disa raste janë joformale, me infrastrukturë të dobët, dhe në shtëpi që janë në kushte të mjera. Për më tepër, anëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, dhe gratë në veçanti, përballen me barriera që çojnë në përjashtimin e tyre nga pjesëmarrja në të gjitha fushat e jetës.”¹²

Si rezultat, komunitetet Rom dhe Ashkali përballen me kufizime të shumta që pengojnë aftësimin e tyre për të arritur nivelin e dëshiruar të kapaciteteve njerëzore, që të marrin pjesë aktive në tregun e punës në baza të barabarta me komunitetet tjera, si dhe gjenerojnë përfitime ekonomike. Niveli i edukimit mbetet akoma jo i kënaqshëm dhe vazhdimi i arsimit të mesëm dhe të lartë në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali është i ulët, edhe pse situata në këtë drejtim është përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit. Angazhimi i dobët në tregun e punës është gjithashtu një dukuri e vazhdueshme dhe nuk është përmirësuar. Në këtë drejtim, mundësitë e komuniteteve Rom dhe Ashkali për të gjeneruar punë dhe të ardhura janë të vogla.

Për të ndihmuar përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare, gjatë viteve 2022-2026, Qeveria ka miratuar këtë Strategji dhe Planin e saj të Veprimit 2022-2024, që përfshijnë objektiva të qarta strategjike të zbërthyer në objektiva specifike si dhe në aktivitete konkrete, realizimi i të cilave do të përmirësojnë dukshëm përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për hartimin e Strategjisë është një kombinim i punëtorive, dërgimit të drafteve përmes komunikimeve elektronike si dhe takimeve individuale me hisedarët kyç vendor dhe ndërkombëtarë, para së gjithash konsultime me përfaqësuesit e komuniteteve Rom dhe Ashkali, në nivel vendi, duke përfshirë por mos u kufizuar edhe në pjesëmarrjen e prindërve, fëmijëve të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve. Përveç kësaj, janë mbajtur takime individuale dhe grupe me përfaqësues të komunave dhe të komuniteteve me qëllim të analizimit të gjendjes aktuale të zbatimit, monitorimit dhe mekanizmave raportues komunal dhe për të mbledhur të dhëna për ridizajnimin e kornizës, me fokus të veçantë në koordinimin ndërmjet nivelit komunal dhe atij qendror.

Pas analizës së shkurtër të gjendjes aktuale, janë përcaktuar objektivat strategjike, objektivat specifike, aktivitetet dhe veprimet konkrete, të cilat janë buxhetuar. Përbushja e këtyre objektiveve do të kontribuojnë edhe në arritjen e synimeve nacionale të përcaktuara sipas OZhQ.

¹¹ Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare 2017-2021, fq. 11.

¹² Po aty.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet të varfërve, të moshuarve, fëmijëve, familjeve të reja dhe familjeve me një prind, vejtshave dhe anëtarëve me aftësitë të kufizuara të komuniteteve.

Strategjia dhe Plani i Veprimit në aspektin strukturor është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi¹³ dhe udhëzimet e Zyrës për Planifikim Strategjik (ZPS), përmes përfaqësuesit të kësaj zyreje në grupin punues, si dhe është bazuar në Kornizën e BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve për vitin 2020-2030.¹⁴

Strategjia është e bazuar në tri parime kryesore dhe është harmonizuar me Kornizën e BE-së për Integrimin e Romëve:

- **Parimi i të drejtave të barabarta dhe mundësive të barabarta:** Ky parim njih nevojën që pjesëtarët nga radhët e komuniteteve Rom dhe Ashkali të kenë mundësi të barabarta në të gjitha fushat e shoqërisë, siç është rasti me popullatën shumicë.

- **Parimi i mosdiskriminimit:** Bazuar në këtë parim të gjitha masat e ndërmarra sigurojnë që, në mënyrë të konsiderueshme, të zvogëlon shkallën e diskriminimit ndaj komuniteteve Rom dhe Ashkali në të gjitha aspektet e jetës shoqërore.

- **Parimi i eliminimit të dallimeve:** - Një nga arsyet kryesore të përjashtimit social të romëve, dhe ashkalinjëve është fakti që ata në shumicën e rasteve jetojnë në vendbanime të ndara dhe të izoluar nga të tjerët. Kështu mekanizmat dhe faktorët socialë riprodhojnë marginalizimin dhe pengojnë masat e veprimit që synojnë përfshirjen sociale.

Procesi i hartimit të Strategjisë ka kaluar në tri faza: 1) faza e parë është karakterizuar me analizimin e situatës së përgjithshme, si dhe realizimin e një varg takimeve konsultative, në të cilat kanë qenë të përfshirë institucionet përgjegjëse dhe aktorët relevant që punojnë në nivel lokal. Gjatë kësaj faze, janë mbajtur takime individuale dhe grupore me përfaqësues të komunave me qëllim të analizimit të gjendjes aktuale të zbatimit, monitorimit dhe mekanizmave raportues komunal dhe për të mbledhur të dhëna për ridizajnimin e kornizës, me fokus të veçantë në koordinimin ndërmjet nivelit komunal dhe atij qendror; 2) përgjatë fazës së dytë janë analizuar dokumente strategjike në fuqi, strategji sektoriale, raporte e vlerësime të ndryshme vendore e ndërkombëtare, të dhëna statistikore dhe anketa të ndryshme të realizuar nga ASK,¹⁵ me theks të veçantë dokumentet që i janë dedikuar komuniteteve Rom dhe Ashkali. 3) Ndërsa, në fazën e tretë draft strategjia dhe plani i veprimit i është nënshtruar procesit të konsultimeve paraprake dhe konsultimeve publike.

Gjatë hartimit dhe finalizimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit, në pajtim me Rregulloren nr. 05/2016 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik, janë zhvilluar procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim administrativ dhe janë mbajtur një varg takimesh, ku ka pasur një pjesëmarrje të gjerë të përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme si dhe përfaqësues nga organizatat e ndryshme

¹³ Udhëzim Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, (04.04.2018).

¹⁴ Korniza e BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve deri në vitin 2020-2030, Bruksel, 07.10.2020, COM (2020) 620.

¹⁵ Shih p.sh. MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ASK, 2020.

joqeveritare, që përfshin por nuk kufizohet në institucionet si në vijim: Zyra e Kryeministrit (ZQM, ZÇK, ZSP, ABGJ, Zyra Ligjore, Zyra e Financave,), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministria për Komunitete dhe Kthim; Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Ministria e Punëve të Brendshme; Agjencia për Regjistrim Civil, Departamenti për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, IKAP; Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria Administrimit Pushtetit Lokal; Agjencia e Punësimit; Ministria e Shëndetësisë; Agjencia e Statistikave të Kosovës; Akademia e Drejtësisë, si dhe një varg OJQ vendore dhe ndërkombëtare.

Pas kalimit të fazave të mësipërme dhe procesit të konsultimeve paraprake dhe konsultimeve publike, janë marrë parasysh komentet dhe sugjerimet e dhëna nga hisedarë të ndryshëm, të cilat janë përfshirë në versionin final të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Hartimi i Strategjisë dhe Planit të veprimit është përkrahur nga Keshilli për Koordinimin Rajonal-Projekti për Integrimin Romeve (RCC) Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) si dhe OJQ VoRAE.

I. SFONDI

1.1. Përshkrimi i gjendjes aktuale dhe përkufizimi i problemit

Qeveria e konsideron shumëllojshmërinë e saj kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare si një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike, ku inkurajon dhe çmon edhe kontributin aktiv të të gjithë personave që i 'u përkasin komuniteteve.

Qeveria është e vetëdijshme për situatën në të cilën ndodhen komunitetet Rom dhe Ashkali dhe është e vendosur të bëjë përpjekje të shtuara për të krijuar kushte sa më të përshtatshme për to, në mënyrë që ata të mund të gëzojnë të drejta të barabarta me të gjitha komunitetet e tjera etnike në Kosovë pa asnjë formë të diskriminimit.

Ky angazhim dëshmohet dhe konkretizohet nëpërmjet miratimit të kësaj Strategjie dhe Planit të saj të veprimit.

Sipas të dhënave të Regjistrimit të fundit të Popullsisë të vitit 2011,¹⁶ në Republikën e Kosovës jetojnë 1,739,825¹⁷ banorë rezidentë. Popullsia e Kosovës sipas përkatësisë etnike/kulturore është si në vijim: 92.9 % shqiptarë, 1.5% serb, 1.1% turk, 1.6% boshnjak, 0.5% rom, 0.9% ashkali, 0.7% egjiptian, 0.6% goran si dhe 0,2 (0,3) janë të tjerë apo që preferojnë të mos përgjigjem apo nuk ka të dhëna në dispozicion.¹⁸ Strategjia në pjesë të madhe është e bazuar në këto statistika, si dhe statistika alternative të raporteve më të reja. Sipas nevojës, synimet e Strategjisë mund të përshtaten me të dhënat e reja me Regjistrimin e ardhshëm të Popullsisë, për t'ju përshtatur sa më shumë statistikave dhe nevojave më reale të viteve në vijim të mbuluar në këtë strategji.

Në tabelat e mëposhtme, janë prezantuar të dhënat duke iu referuar regjistrimit të popullsisë, të ndara sipas komunave ku pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë të përqendruar.

¹⁶ Shih, Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011 - Rezultatet përfundimtare të dhënat kryesore - Agjencia e Statistikave të Kosovës

¹⁷ Shih Vlerësim- Popullsia e Kosovës 2019 Prishtinë Qershor, 2020, fq. 11. Gjatë vitit 2019 migrimi neto është vlerësuar të jetë -28,845 banorë. Popullsia rezidente e Kosovës, për periudhën 01 janar deri me 31 dhjetor 2019 u zvogëluar për - 13,551 banorë. Sipas Tab. 3. Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2019 në nivel të komunave, konsiderohet të jetë 1,782,115.

¹⁸ Popullsia sipas gjinisë etnicitetit dhe vendbanimit - Agjencia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë, Prill 2013, Tab 1.1. Popullsia e Kosovës sipas etnicitetit, gjinisë dhe tipit të vendbanimit - Regjistrimi 2011. Duhet cekur që në bazë të Kushtetutës, qytetarëve u është garantuar liri e plotë e deklaramit të përkatësisë etnike apo grupit kulturor, si rrjedhojë edhe në pyetësorët e Regjistrimit të Popullsisë 2011, u është dhënë mundësia e deklaramit të qytetarëve (apo të drejtës që të mos deklarohet fare) në pajtim me Nenin 57.2 të Kushtetutës, në të cilin përcaktohet: "Çdo pjesëtar i komunitetit do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht nëse do të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit dhe nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që ndërlidhen me këtë zgjedhje, nuk do të rezultojë asnjë diskriminim."

¹⁹ Strategjia në pjesë të madhe është e bazuar në këto statistika, si dhe statistika alternative të raporteve më të reja. Sidoqoftë, Plani i veprimtimit do të jetë dokument i cili do të përshtatet nevojave reale dhe të dhënave demografike dhe do të përditësohet pas zhvillimit të regjistrimit të ri të popullsisë që planifikohet të mbahet pas përfundimit të pandemisë COVID-19.

Tabela 1. Shpërndarja sipas përkatësisë etnike

Etnia	Nr. i përgjithshëm i komuniteteve Rom dhe Ashkali
Rom	8,824
Ashkali	15,436

Burimi: Askdata

Siç ilustron në Tabelën 1, janë 24260 (1.4% e popullsisë totale) Rom dhe Ashkali që jetojnë në Kosovë, të shpërndarë në përqindjet vijuese: rom 0.5% e popullsisë totale, dhe ashkali 0.9% e popullsisë totale).

Tabela 2. Shpërndarja sipas gjinisë

Gjinia	Popullsia totale në Kosovë sipas gjinisë	Përqindja e popullsisë së përgjithshme të Kosovës sipas gjinisë
Mashkull	875,900	50.34%
Femër	863,925	49.66%
Total	1,739,825	100.00%

Burimi: Askdata

Në lidhje me strukturën gjinore të popullsisë për secilin prej komuniteteve specifike e cila është pothuajse e barabartë.

Rom		Ashkali	
Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
4396	4428	7855	7581
49.9%	50.1%	50.9%	49.1%

Burimi: Askdata

¹⁹ Popullsia sipas gjinisë etnicitetit dhe vendbanimit - Agjencia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë, Prill 2013., fq. 64. Tab 5.4 - Popullsia sipas përkatësisë etnike/kulturore, gjinisë dhe komunës

Tabela 3. Shpërndarja sipas grup moshës²⁰

Grup moshë	Rom	%	Ashkali	%	Egjiptian	%	Total sipas grup moshës	% sipas grup moshës
0-4	1,191	13.5%	2,100	13.6%	1,213	10.5%	4,504	12.6%
5-9	1,100	12.5%	2,061	13.4%	1,409	12.2%	4,570	12.8%
10-14	1,067	12.1%	1,902	12.3%	1,445	12.5%	4,414	12.3%
15-19	901	10.2%	1,628	10.5%	1,250	10.8%	3,779	10.6%
20-24	756	8.6%	1,368	8.9%	1,033	9.0%	3,157	8.8%
25-29	631	7.2%	1,159	7.5%	903	7.8%	2,693	7.5%
30-34	578	6.6%	1,046	6.8%	775	6.7%	2,399	6.7%
35-39	524	5.9%	974	6.3%	710	6.2%	2,208	6.2%
40-44	453	5.1%	747	4.8%	549	4.8%	1,749	4.9%
45-49	368	4.2%	622	4.0%	566	4.9%	1,556	4.3%
50-54	347	3.9%	551	3.6%	495	4.3%	1,393	3.9%
55-59	325	3.7%	476	3.1%	350	3.0%	1,151	3.2%
60-64	218	2.5%	309	2.0%	286	2.5%	813	2.3%
65-69	139	1.6%	215	1.4%	217	1.9%	571	1.6%
70-74	119	1.3%	141	0.9%	168	1.5%	428	1.2%
75-79	67	0.8%	64	0.4%	109	0.9%	240	0.7%
80+	40	0.5%	73	0.5%	46	0.4%	159	0.4%
Gjithsej	8,824	100%	15,436	100%	11,524	100%	35,784	100%

Tabela 4. Shpërndarja sipas komunave

Komuna	Total	Rom	Ashkali	Egjiptian	Total %
Deçan	40,019	33	42	393	1.17%
Gjakovë	94,556	738	613	5,117	6.84%
Glllogoc	58,531	0	0	2	0.00%
Gjilan	90,178	361	15	1	0.42%
Dragash	33,997	3	4	3	0.03%

²⁰ Siç është cekur më lartë, të dhënat janë nga Regjistrimi i Popullsisë I vitit 2011, dhe për të dhënat ekzistuese mund të shtohen nga 10 vite në secilën kategori për të përlogaritur statistikën më të përafërta me realitetin në kohën e hartimit të strategjisë. Për grup moshat 0-4 dhe 5-9 nuk ka pothuajse të dhëna zyrtare, përveç ato të regjistrimit të fëmijëve në shkollën fillore (d.t.th. nga moshë 6 e më lartë), për më shumë detaje, shih tabelat 5, 6. Por këto paraqesin vetëm fëmijët e regjistruar në arsim para fillor, dhe numri real parashikohet të jetë shumë më i madh. Me Regjistrimin e ardhshëm të Popullsisë pritet të përditësohen të dhënat, dhe ndryshimet të reflektohen në synimet relevante të objektivave.

Istog	39,289	39	111	1,544	4.31%
Kaçanik	33,409	5	1	0	0.02%
Klinë	38,496	78	85	934	2.85%
Fushë Kosovë	34,827	436	3,230	282	11.34%
Kamenicë	36,085	240	0	0	0.67%
Mitrovicë	71,909	528	647	6	1.64%
Lipjan	57,605	342	1,812	4	3.75%
Novobërdë	6,729	63	3	0	0.98%
Obiliq	21,549	661	578	27	5.87%
Rahovec	56,208	84	404	299	1.40%
Pejë	96,450	993	143	2,700	3.98%
Podujevë	88,499	74	680	2	0.85%
Prishtinë	198,897	56	557	8	0.31%
Prizren	177,781	2,899	1,350	168	2.48%
Skenderaj	50,858	0	10	1	0.02%
Shtime	27,324	23	750	0	2.83%
Shtërpcë	6,949	24	1	0	0.36%
Suharekë	59,722	41	493	5	0.90%
Ferizaj	108,610	204	3,629	24	3.55%
Viti	46,987	12	14	0	0.06%
Vushtrri	69,870	68	143	1	0.30%
Malishevë	54,613	26	5	0	0.06%
Mamushë	5,507	39	12	0	0.93%
Graçanicë	10,675	745	104	3	7.98%
Kllokot	2,556	9	0	0	0.35%
Total	1,739,825	8,824	15,436	11,524	2.06%

Pesë (5) komunat me numrin më të madh me pjesëtarë të komunitetit Rom dhe Ashkali janë Komuna e Gjakovës, Prizrenit, Fushë Kosovës, Ferizaj dhe Pejë.

Përveç kësaj, sipas raportit të profileve komunale të OSBE-së 2018, 12 rom jetojnë në Leposaviq/Leposaviq, ndërsa 200 rom, dhe 40 ashkali jetojnë në Mitrovicë/Mitrovicë Veriore²¹. Regjistrimi i vitit 2011 nuk është kryer në këto dy komuna.

²¹ OSCE, Profilet Komunale, 2018

1.2. Baza ligjore dhe strategjike

Me miratimin e Kushtetutës,²² Kosova mori zotimin dhe përkushtimin për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit. Në këtë drejtim, “*Republika e Kosovës garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Kosovës. Kosova e konsideron shumëllojshmërinë e saj kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare si një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike, që bazohet në sundimin e ligjit. Në zhvillimin e Republikës së Kosovës, inkurajohet dhe çmohet kontributi aktiv i të gjithë personave që iu përkasin komuniteteve*”.²³

Kushtetuta, komunitetet i cilëson banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës.²⁴ Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, e sqaron më tutje këtë përkufizim dhe për qëllimet e këtij ligji, komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazez, kroat dhe komunitete të tjera.²⁵

Siç shihet nga Kushtetuta dhe legjislacionin në fuqi, komunitetet Rom dhe Ashkali janë komunitete të njohura e të pranura në Republikën e Kosovës, të cilët gëzojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Po sipas Kushtetutës, komunitetet gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara në Kapitullin III (Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre) të Kushtetutës, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II (Të Drejtat dhe Liritë Themelore).

Kushtetuta u jep pjesëtarëve të komuniteteve të drejtën që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet.²⁶ Çdo person që i takon një komuniteti ka të drejtë që lirisht të zgjedhë të trajtohet apo të mos trajtohet si i tillë dhe asnjë dëm

²² Kushtetuta u miratua me 9 prill 2008 dhe hyri në fuqi me 15 qershor 2008

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

²³ Ligji nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (GZ, nr. 28, 04 qershor 2008), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 (GZ, nr. 25, 07 shtator 2012) dhe Ligjin nr. 04/L-020 (GZ, nr. 29 / 27 dhjetor 2011). Në tekstin e mëtejshëm: Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Neni 1(1) përcakton si në vijim: Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.

²⁴ Shih Kushtetuta, Neni 57.1.

²⁵ Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, Neni 1 (1.4.). Siç shihet lista e komuniteteve nuk është e përmbyllur dhe “komunitetet tjera” gjithashtu mund të përfitojnë nga këto të drejta.

²⁶ Kushtetuta, Neni 57 (3).

apo diskriminim nuk do të rezultojë nga zgjedhja e ushtrimit apo jo, të të drejtave të cilat lidhen me këtë zgjedhje.²⁷

Po ashtu edhe Neni 58.2 i Kushtetutës përcakton që Republika e Kosovës do të promovojë frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe do të respektoj standardet e përcaktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave.

Ndërsa, Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre garanton për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali (si dhe komunitetet e tjera) një gamë të gjerë të drejtash që pasqyrojnë standardet e Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Ligji parashikon, ndër të tjera, njohjen e gjuhës rome si gjuhë zyrtare që përdoret në nivelin komunal në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve (neni 4.1);²⁸ të drejtën e shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të kulturës dhe traditave të komuniteteve dhe të administrimit të çështjeve të veta kulturore (neni 5); të drejtën e personave që i përkasin komuniteteve të marrin shkollim publik në të gjitha nivelet, në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës që ata e zgjedhin, apo të drejtën në shkollim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre edhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare (neni 8.1); të drejtën e pjesëtarëve të komuniteteve që të gëzojnë pronën e tyre dhe mundësinë për të punuar me kompensim të drejtë dhe të barabartë, pa diskriminim (neni 9.2); të drejtën e personave që u përkasin komuniteteve të kanë përfaqësim të barabartë në punësim (neni 9.5); qasje të barabartë në kujdesin shëndetësor pa diskriminim për personat që iu përkasin komuniteteve (neni 10.1); të drejtën e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre për pjesëmarrjeje efektive në vendimmarrje politike në të gjitha nivelet e qeverisë, përfshirë vendimet që janë me rëndësi të veçantë për ta ose për zonën në të cilën ata jetojnë (neni 11.1).

Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit krijon kushte për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit.²⁹ Programet e veçanta të banimit, sipas Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit, janë forma të banimit të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave dhe kanë nevojë për ndihmën e shtetit, dhe në cilat përfshihen banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira; banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit; banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.³⁰ Burimet e financimit të këtyre programeve të banimit janë nga buxheti i Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit

²⁷ Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, Neni 1 (1.5).

²⁸ Kushtetuta (Neni 5.2.), po ashtu, përcakton që gjuha rome ka statusin e gjuhës zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj.

²⁹ Ligji nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit (Gazeta Zyrtare, nr. 67, 29 mars 2010).

³⁰ Shih Po aty, Neni 2(1.1) dhe Neni 3.

Hapësinor, të hyrat e Komunës të dedikuara për banim, si dhe kontributet e donatorëve të ndryshëm.³¹ Ky ligj, po ashtu, përfshinë edhe kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit³² dhe kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë.³³ Këto programe të veçanta të banimit, siç përcaktohen në Ligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit, duhet të shfrytëzohen edhe për komunitetet Rom dhe Ashkali. Ndërsa, MMPH dhe komunat në këtë drejtim duhet të zbatojnë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.³⁴

Nga dispozitat e mësipërme kushtetuese dhe ligjore, rrjedh se të gjitha të drejtat e të pranuar në Republikën e Kosovës për komunitetet, janë të drejta edhe për komunitetet Rom dhe Ashkali, pa asnjë dallim.

Përveç kësaj, siç edhe përcaktohet në Kushtetutë, Republika e Kosovës duhet të ndërmerr veprime efektive kundër të gjithë atyre që pengojnë gëzimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve.³⁵ Neni 22 i Kushtetutës³⁶ liston marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që garantohen me Kushtetutë dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe përcakton që të njëjtat kanë prioritet ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike, në rast të konflikti.

Kushtetuta dhe marrëveshjet dhe instrumentet që janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë, imponojnë tri lloje apo nivele të detyrimeve të Republikës së Kosovës, përkatësisht: të respektojë, mbrojtë dhe përmbushë secilën nga këto të drejta dhe liri të garantuara me ligj. Detyrimi për t'i respektuar kërkon nga shtetet palë që të shmangin masa që pengojnë ose parandalojnë gëzimin e këtyre të drejtave. Obligimi për të mbrojtur u kërkon shteteve palë që të marrin masa që parandalojnë palët e treta nga ndërhyrjet që pengojnë gëzimin e së drejtës për punësim dhe arsimim. Obligimi për të përmbushur u kërkon shteteve që të marrin masa pozitive që mundësojnë, lehtësojnë, dhe mbështesin individët dhe komunitetet në gëzimin e së drejtës për punësim dhe arsimim.³⁷

³¹ Shih Po aty, Neni 19.

³² Shih Po aty, Neni 4.

³³ Shih Po aty, Neni 5.

³⁴ Shih Neni 24 dhe Neni 25.

³⁵ Shih Kushtetuta, Neni 58.6.

³⁶ Neni 22 i Kushtetutës i liston marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare si në vijim: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese; Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

³⁷ Zbatimi i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Komenti i përgjithshëm nr. 13 (Seanca e 21-të, 1999).

Duhet cekur që, në pajtim me Nenin 53 të Kushtetutës, interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948) i detyron shtetet të respektojnë, mbrojnë dhe respektojnë të drejtat e njeriut. Neni 22 i Deklaratës Universale përcakton se: "*Secili person, si anëtar i shoqërisë, ka të drejtën e sigurimit shoqëror dhe ka të drejtë të ushtrojë të drejtat e tij ekonomike, sociale dhe kulturore të domosdoshme për dinjitetin dhe zhvillimin e lirë të personalitetit të tij, me ndihmën e shtetit dhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, në përputhje me strukturën organizative dhe burimet e secilit shtet*".

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1951) është një dokument në të cilin bazohen parimet e demokracisë moderne në Evropë - sundimi i ligjit dhe mbrojtja uniforme e të drejtave të njeriut dhe lirive individuale. Thelbi i kësaj deklarate bazohet në praktikën dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, të cilat u garantohen të gjithë njerëzve pavarësisht nga cilësitë dhe karakteristikat e tyre personale.

Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (1995) u jep komuniteteve jo shumicë një gamë të gjerë të drejtash në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore, përfshirë mbrojtjen nga politikat ose praktikët që synojnë asimilimin (Neni 5.2).

Këshilli i Evropës ka miratuar një numër rekomandimesh, deklaratash dhe rezolutash ku vëmendje e veçantë i kushtohet të drejtave të romëve (arsimi,³⁸ shëndetësia,³⁹ banimi,⁴⁰ punësimi dhe fuqizimi ekonomik)⁴¹ dhe politikat e përgjithshme të propozuara për përmirësimin e pozitës së burrave rom dhe gratë,⁴² përfshirja e tyre sociale⁴³ dhe parandalimi i diskriminimit ndaj tyre.⁴⁴

Rekomandimet e Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (KERI)⁴⁵ për eliminimin e racizmit dhe paragjyqimeve ndaj romëve janë gjithashtu shumë domethënëse dhe po aq të rëndësishme.

Këtë Strategji, duhet ndërlidhur edhe me Strategjitë tjera, për të siguruar rezultate më të mira të zbatimit dhe llogaridhënies për përmbushjen e objektivave të vendosura në këtë Strategji dhe në Strategjitë tjera dhe të bëhet ndërlidhja më e mirë e objektivave të vendosura në strategjitë

³⁸ Recommendation CM/Rec (2009)4 of the Committee of Ministers to member states on the education of Roma and Travelers in Europe; Recommendation No. R (2000) 4 of the Committee of Ministers on the education of Roma/Gypsy children in Europe.

³⁹ Recommendation Rec (2006)10 of the Committee of Ministers on better access to health care for Roma and Travelers in Europe.

⁴⁰ Recommendation Rec (2005)4 of the Committee of Ministers on improving the housing conditions of Roma and Travelers in Europe.

⁴¹ Recommendation Rec (2001)17 of the Committee of Ministers on improving the economic and employment situation of Roma/Gypsies and Travelers.

⁴² Recommendation CM/Rec (2008)5 of the Committee of Ministers on policies for Roma and/or Travelers in Europe

⁴³ Recommendation CM/Rec (2012)9 of the Committee of Ministers to member States on mediation as an effective tool for promoting respect for human rights and social inclusion of Roma.

⁴⁴ Declaration of the Committee of Ministers on the Rise of Anti-Gypsyism and Racist Violence against Roma in Europe.

⁴⁵ ECRI General Policy Recommendation N°13 on combating anti-Gypsyism and discrimination against Roma;

përkatëse. Përveç strategjisë së skaduar për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali gjatë viteve 2017-2021, dhe planit të veprimit, si dhe planeve lokale për zbatimin e strategjisë në nivelin lokal, ka edhe politika të tjera që janë relevante për përfshirjen e shtuar të komuniteteve Rom dhe Ashkali dhe që janë shfrytëzuar në procesin e zhvillimit të kësaj Strategjie dhe është bërë ndërlidhja me këto dokumente strategjike. Në këtë drejtim, dokumentet strategjike të cilat kanë ndërlidhje me procesin e përfshirjes së komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare, janë si në vijim:

1. **Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (2021-2025)**⁴⁶ u miratua nga Qeveria duke synuar zhvillimin socio-ekonomik të bazuar mbi largimin e pengesave ndaj përmbushjes së të drejtave dhe lirive themelore, përfshirë atyre ekonomike, që do të ndihmojnë qytetarin të punojë, kursejë, konsumojë dhe të jetojë me dinjitet e në paqe. Siç është përcaktuar në këtë Program, “Mbi supet e Republikës qëndron përgjegjësi e madhe: të sigurojë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke respektuar standardet e mishëruara në konventa ndërkombëtare e atyre brenda praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.” Programi, po ashtu, është i ndërlidhur dhe plotësohet nga programe dhe strategji tjera sektoriale që adresojnë fusha specifike të të drejtave të njeriut, dhe është i ndërlidhur edhe me këtë Strategji.
2. **Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024**⁴⁷ synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve. Strategjia ndërlidhet me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, dhe sw bashku duhet tw shwrbjenw si platformë e avancimit të barazisë gjinore në Kosovë duke i kushtuar vwmendje aktiviteteve qw kanw tw bwjnw me arritjen e barazisë gjinore nw radhwt e pjestarwve tw komuniteteve Rom dhe Ashkali qw ndwrlidhet edhe me objektivin e përgjithshëm strategjik tw Programit të Kosovës për Barazi Gjinore i cili është të sigurojë që barazia gjinore të jetw në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër te të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.
3. **Strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023**⁴⁸ synon të ofrojë një kornizë të qëndrueshme të veprimeve që ka për qëllim të adresojë sfidat dhe pengesat si dhe të promovon një

⁴⁶ Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (2021-2025) Tetor 2021. <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2021/11/SHQIP-PROGRAMI-PER-MBROJTJEN-E-TE-DREJTAVE-TE-NJERIUT-2021-2023.pdf>

⁴⁷ Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 u miratua nga Qeveria me 23.05.2020 me Vendimin nr. 01/34.

⁴⁸ Strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023 (Prishtinë, 2013) <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2019/09/PLANI-NACIONAL-P%C3%8BR-T%C3%8BDREJTAT-E-PERSONAVE-ME-AFT%C3%8BSI-T%C3%8BD-KUFIZUAR-N%C3%8B-REPUBLIK%C3%8BN-E-KOSOV%C3%8BS-2018-2020-002.pdf>

shoqëri gjithëpërfshirëse dhe përmirësimin e gjendjes aktuale në këto fusha: Shëndetësia; Mirëqenia Sociale; Punësimi; Edukimi; Mbrojtja Ligjore; Pjesëmarrja, Informimi Komunikimi, Qasje dhe Statistika. Për më tepër kjo strategji duhet të shërbejë si një udhërrëfyes për institucionet e Republikës së Kosovës për të punuar brenda parimeve mos-diskriminuese, duke respektuar të drejtat edhe të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali me aftësi të kufizuara.

4. **Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019–2023**⁴⁹ i përkufizon objektivat strategjike dhe politikat që Qeveria synon t'i arrijë në një periudhë afatmesme për përmirësimin e mjedisit përkrahës në zhvillimin e shoqërisë civile si dhe krijimin e parakushteve për një bashkëpunim më efektiv me OSHC-të për reformat kryesore në vend. Shoqëria civile e fuqizuar dhe aktive mund të kontribuojë në formësimin e një legjislacioni më të mirë, ofrimin e shërbimeve më të mira publike, sigurimin e monitorimit më efikas të zbatimit të reformave kyçe të politikave dhe përmirësimin e vullnetarizmit qytetar. Roli i shoqërisë civile në procesin e parandalimit dhe luftimit të diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali dhe arritjen e objektivave strategjike të kësaj strategjie është i pashmangshëm dhe në frymën e kësaj duhet parë edhe ndërlidhjen me këtë strategji. Qeveria përmes partneritetit me shoqërinë civile, përmes një sërë shërbimesh ose masash mbështetëse për të ndihmuar komunitetet Rom dhe Ashkali të promovojnë barazi dhe mundësi për integrim dhe përfshirje.

1.3. Mekanizmat për mbrojtjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës (2008) dhe krijimi i shumë mekanizmave në nivel qendror dhe lokal, po ashtu ka ndikuar që komunitetet në përgjithësi të kenë një integrim më të mirë në shoqërinë kosovare dhe të jenë pjesëmarrës në jetën publike dhe politike në Kosovë.

Përmes mekanizmave të ndryshëm në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal, Kosova mundëson përkrahjen për të drejtat e komuniteteve jo shumicë. Përderisa, disa nga këto mekanizma kanë të bëjnë me mbrojtjen e tyre nga diskriminimi, të tjerat merren edhe me çështje që lidhen me pjesëmarrjen në vendimmarrje.

Kushtetuta, ligjet dhe aktet nënligjore kanë krijuar mekanizma të ndryshëm të cilat kanë detyra dhe përgjegjësi që të përkujdesen për promovimin, mbrojtjen dhe realizimin e interesave të komuniteteve duke përfshirë edhe përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare.

Në radhë të parë, korniza institucionale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, ndahet në: institucionet gjyqësore dhe në institucionet jo gjyqësore. Institucionet

⁴⁹ Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019–2023 (Prishtinë 2019) <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2019/08/Strategjia-ne-tri-gjuhe.pdf>

gjqësore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve janë: Gjykata Kushtetuese⁵⁰ dhe Gjykatat e Rregullta (Gjykata Supreme, si autoriteti më i lartë gjyqësor; Gjykata e Apelit dhe Gjykatat themelore). Ndërsa institucionet jo gjyqësore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve ndahen në dy lloje: Institucionet e pavarura dhe institucionet qeveritare. Në institucione të pavarura bëjnë pjesë: Presidenti;⁵¹ Komisioni i Kuvendit për të Drejtat dhe interesat e Komuniteteve;⁵² Këshilli Konsultativ për Komunitete;⁵³ Avokati i Popullit;⁵⁴ Agjencia për Ndhmë Juridike Falas;⁵⁵ Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës. Në institucione qeveritare⁵⁶ bëjnë pjesë: Zyra e Kryeministrit (në kuadër të së cilës janë: Agjencia për Barazi Gjinore; Zyra për Qeverisje të Mirë; Zyra për Çështje të Komuniteteve; Zyra e Komisionerit për Gjuhë); Ministria për Komunitete dhe Kthim; Ministria

⁵⁰ Shih Kushtetuta, Neni 4.6. dhe Neni 112. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

⁵¹ Besim M. Kajtazi & Florent Muçaj: Roli dhe pozita juridike e Presidentit të Republikës së Kosovës- 111 pyetje dhe përgjigje, AAB, Prishtinë 2021, fq. 49.: Presidenti përfaqëson shtetin dhe unitetin e popullit, në këtë drejtim është përgjegjësi e Presidentit të sigurojë liritë dhe të drejtat njerëzore e qytetare sepse mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore është vendimtare për të garantuar funksionimin kushtetues dhe demokratik të institucioneve. Në këtë kontekst, Presidenti nuk mund të qëndroj indiferent dhe të lejoj që të shkelen (cenohen) liritë dhe të drejtat njerëzore e qytetare, sepse me shkeljen e tyre do të rrezikoheshin parimet demokratike dhe tërë sistemi kushtetues. Andaj, i takon Presidentit që si përfaqësues i unitetit të popullit, sipas Nenit 83 të Kushtetutës, të parandalojë situata ku shkelen liritë dhe të drejtat njerëzore e qytetare, duke përdorur mekanizmat kushtetues dhe ligjor në dispozicion.

⁵² Kushtetuta, Shih Neni 77 Neni 78.4.: Komisionet e Kuvendit - Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve: Kuvendi i Kosovës emëron komisione të përhershme, komisione funksionale dhe komisione ad hoc, që pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit, njëherit edhe duhet të pasqyrojnë edhe natyrën shumetnike të Kosovës. Në kuadër të Komisioneve të përhershme të Kuvendit bën pjesë edhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, me nismën e vet, mund të propozojë ligje dhe masa të tilla të tjera brenda përgjegjësisë të Kuvendit, të cilat i konsideron se janë të duhura për të adresuar interesat e komuniteteve.

⁵³ Këshilli Konsultativ për Komunitete ndihmon në organizimin dhe artikullimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për to dhe ofron një mekanizëm për shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore me qëllim të ngritjes së vetëdijes për brengat e komuniteteve brenda Republikës së Kosovës dhe t'u kontribuojë marrëdhënieve harmonike midis të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.

⁵⁴ Në Kushtetutë, parashikohet edhe IAP, i cili mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike në Kosovë. Kushtetuta në Kapitullin e saj të XII (Institucionet e Pavarura), në 4 nene, nga neni 132 deri 135 përcakton funksionin, parimet e veprimtarisë, statusin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit, Shih Ligji nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit (GZ, Nr. 16 / 26 qershor 2015), Neni 16.: Avokati i Popullit ka kompetenca, në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit. Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

⁵⁵ Ligji nr. 04/l-017 për ndihmë juridike falas (GZ, nr. 03, 22 shkurt 2012), Neni 1. Ligji për ndihmë juridike falas ka krijuar një sistem funksional (Këshillin për ndihmë juridike dhe Agjencinë për ndihmë juridike falas) për ndihmë juridike falas në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse, me anë të të cilit sigurohet qasje efektive në drejtësi për qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

⁵⁶ Qeveria përfshinë Kryeministrin, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Qeveria, duke ushtruar pushtetin ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ka një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, e cila duhet të iniciojë masa dhe veprime të ndryshme në realizimin e të drejtave të komuniteteve dhe për të kontribuar në mbrojtjen nga diskriminimi e në veçanti në promovimin e parimit të trajtimit të barabartë.

e Financave, Punës dhe Transfereve; Ministria për Administrim të Pushtetit Lokal (MAPL), si dhe Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Strategjia është dokument i Qeverisë dhe si rrjedhojë në një dokument i tillë mund të obligojë vetëm organet qeveritare, por domosdo të gjitha institucionet kanë obligimet e veta përkatëse ligjore, që në një mënyrë ndërlidhen edhe me objektivat strategjike të Strategjisë. Pa harruar këtu rolin e madh që kanë organizatat e shoqërisë civile në procesin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve.

II. OBJEKTIVAT

Përfshirja e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare është interes afatgjatë i Qeverisë dhe i gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Përmes përfshirjes edhe të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali zvogëlohet hendeku ekzistues në mes të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve dhe qytetarëve të tjerë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, duke ndikuar drejtpërdrejt në zvogëlimin e varfërisë që dominon tek këto komunitete. Korniza e BE-së për Integrimin e Romëve, ka përcaktuar tre objektiva horizontale, në fushat e barazisë, përfshirjes dhe pjesëmarrjes. Katër të tjerët janë objektiva sektoriale në fushat e arsimit, punësimit, strehimit dhe shëndetësisë. Ky dokument bazohet edhe në: Agjendën për Reforma Evropiane (ARE), Strategjinë e Evropës Juglindore 2020 të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) dhe Udhërrëfyesin për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016- 2021, si dhe Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) për komunitetet Rom dhe Ashkali në Kosovë të realizuar në 2019-2020.⁵⁷

Përcaktimi i objektivave strategjike është bërë duke u bazuar në rezultatet e zbatimit të Strategjive paraprake⁵⁸, Raporti Afatmesem për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2019 Kornizën e BE-së për Integrimin e Romëve, Programin e Qeverisë si dhe strategjive tjera sektoriale. Përmbushja e këtyre objektivave do të kontribuojnë edhe në arritjen e synimeve të OZhQ në Kosovë. Objektivat strategjike janë në përputhje dhe kontribuojnë në qëllimin kryesorë të Agjendës 2030 që bënë thirrje për zhdukjen e varfërisë në të gjitha format dhe eliminimin e pabarazive, rritjen e

⁵⁷ Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). 2020

⁵⁸ Raporti Afatmesem për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2019

mundësive të të gjithë fëmijëve që të kenë sukses në të arriturat arsimore (OZhQ 1⁵⁹, 4⁶⁰, 5⁶¹ dhe 10⁶²), shërbime kualitative shëndetësore dhe sociale, punësim (OZhQ 2⁶³ dhe 3⁶⁴, 8⁶⁵), parandalimin e dukurive negative dhe dëgjimi i zërit të tyre (OZhQ 16⁶⁶).

Në vitin 2008, Qeveria aprovoi Strategjinë për Integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015⁶⁷, gjithashtu edhe Planin e Veprimit për zbatimin e saj,⁶⁸ duke i identifikuar fushat e rëndësisë së veçantë për integrimin e këtyre komuniteteve.⁶⁹ Strategjia kishte për fokus njëmbëdhjetë fusha prioritare: Anti-diskriminimin; Arsimin; Punësimin dhe fuqizimin ekonomik; Shëndetin dhe çështjet sociale; Strehimin dhe vendbanimet joformale; Kthimin dhe Riintegrimin; Regjistrimin dhe dokumentacionin; Çështjet gjinore; Kulturën, mediat dhe informimin; Pjesëmarrjen dhe përfaqësimin politik; Sigurinë (punën policore). Po të njëjtat fusha janë të përfshira edhe në dokumentin e Strategjisë 2017-2021, të zhvilluar nga Qeveria. Këtu duhet theksuar se nuk janë harruar edhe fushat e tjera me rëndësi për të siguruar përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në periudhën 2017-2021, siç janë: regjistrimi civil, kthimi dhe ri-integrimi dhe siguria. Krahas këtyre fushave, Strategjia për periudhën 2022-2026 është e bazuar në premisat e njëjta të nevojave prioritare dhe Kornizës së BE-së për integrimin e romëve, dhe si rezultat përfshin edhe Diskriminimin si fushë prioritare të veprimit.

Që të arrihen synimet e Strategjisë janë caktuar pesë objektiva strategjike si në vijim:

Objektiva strategjike 1: Rritja efektive e ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet Rom dhe Ashkali;

Objektiva strategjike 2: Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm, si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve Rom dhe Ashkali;

Objektiva Strategjike 3: Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore;

⁵⁹ Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj në secilin vend.

⁶⁰ Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës.

⁶¹ Barazia Gjinore.

⁶² Ulja e pabarazisë brenda dhe midis vendeve.

⁶³ Zhdukja e urisë, të arrihet sigurimi i ushqimit dhe të ushqyerit e përmirësuar si dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme.

⁶⁴ Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë për të gjitha moshat.

⁶⁵ Promovoni rritje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.

⁶⁶ Promovoni shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe ndërtoni institucione efektive, të përgjegjshme dhe përfshirëse në të gjitha nivelet.

⁶⁷ Strategjia për Integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009-2015.

⁶⁸ Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, 2009- 2015.

⁶⁹ 1. Arsimi, 2. Punësimi dhe fuqizimi ekonomik, 3. Shëndetësia dhe çështjet sociale, 4. Strehimi dhe vendbanimet joformale, 5. Kthimi dhe ri integrimi, 6. Regjistrimi, 7. Kultura, mediat dhe informimi, 8. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi, 9. Siguria, shërbimi policor, drejtësia, 10. Kundër- diskriminimi dhe 11. Barazia gjinore

Objektiva Strategjike 4: Rritja e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm, shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike, për komunitetet Rom dhe Ashkali;

Objektiva Strategjike 5:⁷⁰ Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjyqimeve, stereotipeve, dhe bullizmit.

⁷⁰ Objektiva strategjike 5 i adreson format kyçe të manifestimit të antigjipsizmit, ashtu si parasheh Korniza e BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve deri në vitin 2020-2030.

Ekzistojnë një numër i madh i përkufizimeve për antigjipsizmin, si psh.: Council of Europe ECRI General Policy Recommendations No.13 on combating anti-Gypsyism and discrimination against Roma, 2011: Antigypsyism is a specific form of racism, an ideology founded on racial superiority, a form of dehumanisation and institutional racism nurtured by historical discrimination, which is expressed, among others, by violence, hate speech, exploitation, stigmatisation and the most blatant kind of discrimination; is especially persistent, violent, recurrent and commonplace form of racism. The Council of Europe's Human Rights Commissioner report on Human rights of Roma and Travellers in Europe", 2012 defines "anti-Gypsyism" as "the specific expression of biases, prejudices and stereotypes that motivate the everyday behaviour of many members of majority groups towards the members of Roma and Traveller communities". Alliance against antigypsyism working definition, 2016: Antigypsyism is a historically constructed, persistent complex of customary racism against social groups identified under the stigma 'gypsy' or other related terms and incorporates: 1. a homogenizing and essentializing perception and description of these groups; 2. an attribution of specific characteristics to them; 3. discriminating social structures and violent practices that emerge against that background, which have a degrading and ostracizing effect and which reproduce structural disadvantages.

Figura 1: Pasqyrë e objektivave strategjike dhe rezultateve të ndërlidhura sipas pesë fushave.



2.1. Arsimi

Objektiva Strategjike 1: Rritja efektive e ofrimit të mundësisë, qasjes së barabartë dhe mbarëvajtjes në arsim cilësor gjithëpërfshirës për komunitetet Rom dhe Ashkali

Arsimi është faktori i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm për parandalimin e varfërisë dhe përfshirjen në shoqëri. Është mirë e njohur se personat e paarsimuar, ata që fillojnë vonë arsimimin e tyre, ose ata që e braktisin herët arsimin, kanë vështirësi në punësim dhe si rrjedhojë, mundësitë e tyre në jetë janë më të kufizuara. Programet për arsimimin e të rriturve mund ta kompensojnë deri në një masë mungesën e arsimit formal, por ato nuk duhet të jenë alternativa e parë për të siguruar arsimimin e pjesëtarëve të një komuniteti.

Arsimi ndikon pozitivisht edhe në shëndetin fizik dhe mendor, sigurinë, angazhimin qytetar dhe zhvillimin shoqëror. Adoleshentët mund të përballen gjithashtu me rrezikun e braktisjes së shkollës, martesës së hershme ose shtatzënisë, ose detyrohen të punojnë para kohe. Niveli i ulët i shkathtësive themelore të leximit dhe të numërimit përfshijnë një numër të madh të fëmijëve në Kosovë, por për fëmijët nga komunitetet rom dhe shkali ky nivel është dyfish më i dobët.

Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021⁷¹ përfshin një varg masash që kanë të bëjnë me arsimimin e komuniteteve Rom dhe Ashkali, por edhe të grupeve të tjera të marginalizuara. Disa nga ato masa janë dhënë më poshtë, në formë të përshtatur, ndërsa disa masa tjera janë specifike për këtë Strategji.

Për arritjen/përmbushjen e Objektivës Strategjike 1, teoria e ndryshimit parasheh 1) që me rritjen e vetëdijesimit dhe ndërgjegjësimit të komuniteteve dhe të gjithë akterëve relevant të arsimit mbi rëndësinë e arsimimit të komuniteteve, do të rritet niveli regjistrimit dhe qasjes së barabartë në arsim; 2) përmes programeve të specializuara plotësuese dhe masave afirmative në arsim, do të rritet niveli i arritjeve të nxënësve nga komunitetet dhe me të edhe vijueshmëria; dhe 3) përmes ndërgjegjësimit ndaj bullizmit dhe promovimit të historisë dhe kulturës së komuniteteve Rom dhe Ashkali, në të gjitha nivelet e arsimit, do të arrihet ulja e diskriminimit sistematik dhe integrimi i mirëfilltë i pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqëri.

⁷¹ Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021, korrik 2016, parashih masa për arritjen e disa treguesve specifikë për arsimin e komuniteteve Rom dhe Ashkali deri në vitin 2021: Përfshirja e fëmijëve Rom dhe Ashkali në edukimin para fillor (Caku: 70%); Përfshirja e fëmijëve Rom dhe Ashkali në arsimin fillor (Caku: 95%); Përfshirja e fëmijëve Rom dhe Ashkali në arsimin e mesëm të ulët (Caku: 85%); Përfshirja e fëmijëve Rom dhe Ashkali në arsimin e mesëm të lartë (Caku: 50%); Shkalla e transicionit në arsimin e mesëm të lartë për fëmijët Rom dhe Ashkali (Caku: 80%); Indeksi i paritetit gjinor për komunitetet Rom dhe Ashkali (Caku: SHFMU – 1, SHML – 0.90).

Për të arritur Objektiven Strategjike 1, janë paraparë këto objektiva specifike:

1.1 Objektiva Specifike 1: Vetëdijesimi dhe promovimi i rëndësisë së arsimit dhe përfshirjes të fëmijëve nga komunitetet Rom dhe Ashkali në të gjitha nivelet e arsimit dhe tek të gjithë akterët relevantë;

1.2 Objektiva Specifike 2: Përmirësimi i performancës akademike të nxënësve dhe studentëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali përmes programeve të specializuara plotësuese dhe masave afirmative në arsim;

1.3 Objektiva Specifike 3: Luftimi i diskriminimit, racizmit, stigmatizimit, gjuhës së urrejtjes, dhunës së urrejtës dhe bullizmit; në shkolla dhe promovimi i kulturës dhe historisë së komuniteteve Rom dhe Ashkali.

E Drejta për Arsimim është një nga të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura dhe të garantuara me Nenin 47 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Neni 47 [E Drejta për Arsimin]

1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike.

2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.

Për të garantuar demokracinë dhe respektimin e të drejtave të njeriut, e drejta për arsimim duhet të respektohet, mbrojtur dhe plotësuar me të gjitha masat ligjore dhe masa të tjera sistematike që një shtet ofron përmes sistemit të arsimit.

Qëllimi i Kornizës së BE për integrimin e Romëve në arsimim është të "sigurojë që të gjithë fëmijët rom të përfundojnë, si minimum, arsimin fillor".⁷²

Me zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2017-2021 dhe me ndërmarrjen e masave nga Qeveria e Kosovës dhe Autoritetet Lokale është arritur një përmirësim në fushën e mirëqenies, shëndetësisë si dhe i pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali në sistemin arsimor. Megjithatë, përfshirja e komuniteteve Rom dhe Ashkali në sistemin arsimor, si dhe braktisja e shkollimit nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve, ende mbeten sfida, edhe pse situata është përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit. MASHTI dhe MPB kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me qëllim të integritit në sistemin arsimor publik të Republikës së Kosovës të fëmijëve të riadhesuar, prej së cilës pritet të përfitojë një numër i konsiderueshëm i fëmijëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali. Po ashtu, MASHTI ka nxjerrë akte nënligjore të veçanta për ta lehtësuar përfshirjen e fëmijëve të ri-atdhesuar në sistemin e shkollimit në Kosovë. Është ofruar mundësia e mësimi të gjuhës rome si lëndë zgjedhore, ndërsa në arsimin e lartë

⁷² 2019, POST-2020 EU ROMA STRATEGY: THE WAY FORWARD

MASHTI ka nxjerr udhëzimin administrativ për përcaktimin e vendeve të rezervuara për studentët që u përkasin komuniteteve jo shumicë, duke përfshirë pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali⁷³.

Romët dhe ashkalitë përgjithësisht kanë nivel më të ulët arsimimi dhe kalojnë më pak vite në shkollë krahasuar me grupet e tjera të popullsisë. Si rrjedhojë, niveli i arsimimit, i shkërim-it-leximit të komuniteteve Rom dhe Ashkali është më i ulët sesa mesatarja në shkollë vendi.⁷⁴ Varfëria ekstreme është një nga shkaqet e nivelit të ulët të arsimimit të komuniteteve romë dhe ashkali, sepse shumica prej tyre nuk mund të përballojnë shpenzimet e shkollimit. Të ardhurat mujore për frymë midis romëve dhe ashkalive janë më të ulëta sesa ato të popullsisë së përgjithshme në Kosovë. Shumë shpesh fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian hyjnë në tregun e punës në një moshë shumë të hershme⁷⁵ në mënyrë që të kontribuojnë për mbijetesën e familjeve të tyre, dhe për këtë shkak fëmijët nuk regjistrohen në shkollë ose ata e braktisin shkollën shumë herët.

Paaftësia për të folur gjuhën shqipe apo gjuhën serbe për fëmijët e komunitetit rom është një nga vështirësitë me të cilën përballen fëmijët rom kur fillojnë të shkojnë në shkollë. Për shkak të vështirësive gjuhësore ata përballen me vështirësi në shkollë dhe për pasojë kemi braktisje të madhe të shkollës.

Me gjithë progresin në rritjen e pjesëmarrjes në arsim të komuniteteve Rom dhe Ashkali, dallimi me mesataren e Kosovës vazhdon të jetë domethënës. Tek fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian vërehet një përfshirje tejet e ulët në edukimin parashkollor dhe të mesëm të lartë, ndërkohë që shkalla e regjistrimit bruto në arsimin e detyrueshëm (klasat 1-9) është rreth 85% që, përsëri, është dukshëm nën mesataren e vendit.⁷⁶

Pra, përfshirja e komuniteteve rom, dhe ashkali në sistemin arsimor, si dhe braktisja e shkollimit nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve, ende mbeten sfida për shoqërinë. Këtë e pasqyrojnë edhe të dhënat statistikore të mëposhtme.

Tabela 5, jep të dhëna për regjistrimin e fëmijëve/nxënësve të komuniteteve Rom dhe Ashkali në arsimin para universitar, ndërsa tabela 6, është bërë një krahasim ndër vite. Ndërkohë që numri i

⁷³ Udhëzim Administrativ (MASHT) Nr.09/2016 Aplikimi i masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet jo shumicë në institucionet publike të arsimit të lartë. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/ua-masht-09-2016-aplikimi-i-masave-afirmative-dhe-vendeve-te-rez-al.pdf>

⁷⁴ Sipas një studimi të Agjencisë së Statistikave të Kosovës: Komunitetet Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014, niveli i lexim-shkërim-it te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është shumë i ulët në krahasim me popullatën shumicë, dhe e njëjta gjë vlen për nivelin arsimor të komuniteteve. Të dhënat kryesore të këtij studimi që kanë të bëjnë me nivelin arsimor të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë prezantuar në vijim: Aftësia për lexim shkërim – (a) Femra – 72.8 % (98% në nivel të Kosovës). (b) Meshkuj – 86.5 % (97.6% në nivel të Kosovës). Vijueshmëria e arsimit në moshë të hershme: 16.1% (13.9% në nivel të Kosovës). Përgatitja për shkollë: 53.9 % (75.5 % në nivel të Kosovës). Shkalla neto e regjistrimit në arsimin fillor: 68.1% (91.6% në nivel të Kosovës). Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që aktualisht vijojnë arsimin fillor ose të mesëm: 85.3 % (98% në nivel të Kosovës).Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët që aktualisht vijojnë shkollën e mesme të ulët ose më shumë: 65.0 % (95.9% në nivel të Kosovës). Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të lartë, që aktualisht vijojnë shkollën e mesme të lartë ose më shumë: 30.3 % (82% në nivel të Kosovës).

⁷⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014: Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare, të cilët janë të angazhuar në punë: 16.6 % (10.7% në nivel të Kosovës).

⁷⁶ Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, Prishtinë, korrik 2016.

lartë i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është inkurajues, numri i ulët i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë dhe në arsimin parashkollor dhe para fillor mbetet një shqetësim, dhe nevojitet punë e mëtejshme për të arritur përfshirjen e plotë në këto nivele të arsimit. Nga tabela 6 vërehet një trend i lehtë i rritjes në regjistrime në periudhën 2016/17-2020/21 që mund të jetë rezultat i politikave shtetërore që kanë ndikuar në vetëdijesimin e popullatës, ndërkaq gjendja në vitin 2019/20 mund të jetë rezultat i COVID-19 që ka rezultuar me një numër më të vogël të nxënësve të komuniteteve Rom dhe Ashkali.

Tabela 5. Nxënësit sipas përkatësisë etnike dhe niveleve shkollore 2020/21

Niveli	Ashkalinjë	Rom	Gjithsej
Arsimi parashkollor (mosha 0<5)	3	4	7
Arsimi parashkollor/parafillor (mosha 0<6)	216	88	304
Arsimi fillor/mesëm i ulët	3755	1072	4827
I mesëm i lartë	224	170	394
Gjithsej	4195	1330	5525

(Burimi: Të dhëna nga statistikat vjetore të MASHTI)

Tabela 6. Krahasimi i numrit të nxënësve nder vite

Përkatësia etnike	2016/2017	2017/2018	2018/2019	2019/20	2020/21
Rom dhe Ashkali	6,268	6,662	6,835	6,754	6,863

(Burimi: Të dhëna nga statistikat vjetore të MASHTI)

Në favor të kësaj flet edhe ulja e braktisjes së shkollimit në vitet shkollore 2016/17 dhe 2020/21 e cila shihet nga tabela 8. Tendenca në rënie në numrin e braktisjeve mund t'i atribuohet së paku pjesërisht punës së ndërmjetësve të shkollave, qendrave mësimore dhe ekipeve të parandalimit dhe reagimit (PRTAN). Për të zvogëluar më tej numrin e nxënësve që braktisin shkollën, efektiviteti i EPRBM -ve duhet të rritet më tej.⁷⁷ Përveç varfërisë shkaqet e tjera të braktisjes duhet të kërkohen edhe tek vetëdijesimi i ulët për rëndësinë e shkollimit ku disa prej tyre ndërprejnë mësimin për shkaqe të punësimit dhe martesat e hershme të vajzave

⁷⁷ KEC report, 2020
http://kec-ks.org/ëp-content/uploads/2020/08/Report_focused_on_effectiveness_of_prtans_among_roma_ashkali_and_egyptian_children-1_ENG.pdf

Tabela 7. Nxënës braktisës

2017/18	Klasa	Rom			Ashkali		
		M	F	Gj	M	F	Gj
	Kl. 1-9	26	28	54	12	2	14
	Kl. 10-13	0	0	0	2	1	3
	Gjithsej	26	28	54	14	3	17
2018/19	Klasa	Rom			Ashkali		
		M	F	Gj	M	F	Gj
	Kl. 1-9	27	21	48	5	2	7
	Kl. 10-12	2	1	3	5	0	5
	Gjithsej	29	22	51	10	2	12
2019/20 Gjysmë vjetori i parë	Klasa	Rom			Ashkali		
		M	F	Gj	M	F	Gj
	Kl. 1-9	12	14	26	0	0	0
	Kl. 10-12	1	1	2	4	3	7
	Gjithsej	13	15	28	4	3	7

(Burimi: Të dhëna nga statistikat vjetore të MASHT)

Tabela 8. Krahasimi i numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën ndër vite

Përkatësia etnike	2017/2018	2018/2019	2019/20
Rom dhe Ashkali	88	83	50

(Burimi: Të dhëna nga statistikat vjetore të MASHT)

Situata në lidhje me shkollimin është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme, kjo u ndihmua nga dhënia e bursave nga MASHTI,⁷⁸ në bashkëpunim me partner REF dhe VORAE për vitin shkollor 2020/2021 ka ndarë 596 bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta për komunitetet Rom dhe Ashkali. MASHTI për vitin shkollor 2020/2021 ka ndarë 333 bursa, REF ka ndarë 103 bursa dhe VoRAE ka ndarë 160 bursa. Nga buxheti i MASHTI për vitin shkollor 2021/2022 për bursa janë ndarë gjithsej 150.000 euro, që dalin sërish diku rreth 500 bursa për këtë vit shkollor.

⁷⁸ Raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Qasja e komuniteteve në arsimin para universitar në Kosovë, dhjetor 2018, në dispozicion në <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/406952> (qasur më 17 shtator 2019), f. 18.

Tabela 9. Të dhënat e arsimit në Kosovës duke u bazuar në indikatorët e SDG-ve

SDG	Indikatorët e MICS-it	Të dhënat	Vlerat		
			Edukimi Primar 6-11 vjeç	Edukimi Sekondar i ulët 12-15 vjeç	Edukimi Sekondar i Lartë 16-18 vjeç
4.1.2	LN.8a,b,c	Shkalla e përfundimit	85%	59%	24%
4.1.4	LN.6a,b,c	Shkalla jashtë shkollës	13%	21%	58%
4.1.5	LN.10a,b,c	Përqindja e fëmijëve mbi moshën për klasën	12%	15%	Na
4.5.1	LN.5a	Indekset e barazisë gjinore (vajzat/djemtë)	0.97	0.98	0.99
4.5.1	LN.5b	Indekset e barazisë së pasurisë (më të varfrit/më të pasurit)	0.80	0.50	0.25
4.5.1	LN.5c	Indekset e barazisë së zonës (rurale/urbane)	1.07	1.21	0.80
			Total	Djem	Vajza
4.2.2	LN.2	Shkalla e pjesëmarrjes në mësimin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të hyrjes fillore)	45%	47%	43%

(Burimi: Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) për komunitetet Rom dhe Ashkali në Kosovë të realizuar në 2019-2020)⁷⁹

Bazuar në Tabelën 9, numri i nxënësve që nuk e përfundojnë mësimin është më i madh tek fëmijët e komuniteteve Rom dhe Ashkali, me rreth dy të tretat që përfundojnë shkollën e mesme të ulët (59 përqind) dhe vetëm një të katërtën përfundojnë shkollën e mesme të lartë (24 përqind).

Rënja e numrit të fëmijëve e komuniteteve Rom dhe Ashkali që ndjekin arsimin e mesëm dhe të ulët (klasat 6-9) 59% krahasuar me sa ishin të regjistruar në atë primar (85%), paraqet një shkallë të braktisjes prej 30%. Ky numër i zvogëluar i nxënësve në arsim sekondar të ulët, rrezikohet edhe më tej nga fakti se janë 2 ose më shumë vjet më të vjetër se moshja përkatëse për klasën që po ndjekin.

Nivelet e frekuentimit të nxënësve në shkolla janë më të larta në të tre nivelet në zonat rurale dhe në mesin e fëmijëve që jetojnë në familjet më të pasura.

⁷⁹ MICS per komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ASK, 2020.


Praktikisht barazia e plotë gjinore në të gjitha nivelet e arsimit është një fenomen pozitiv dhe tregon se është arritur progres i rëndësishëm në përfshirjen e vajzave romë dhe ashkalike në arsim. Është thelbësore të sigurohet që kjo prirje të vazhdojë në afat të gjatë dhe t'i kushtohet vëmendje përfshirjes së vajzave dhe djemve në arsim në të gjitha nivelet.

Vetëm 2 nga 5 fëmijë të moshës 7–14 vjeç në Kosovë kanë shkathtësi themelore të leximit dhe shkathtësi themelore numerike. Përqindjet janë edhe më të ulëta në mesin e fëmijëve që jetojnë në komunitetet Rom dhe Ashkali (përkatesisht 1 në 5 dhe 1 në 10) ⁸⁰.

Ndërsa nivelet e vijueshmërisë të shkollës fillore dhe të mesme të ulët janë mbi 90 për qind, ato bien për shkollën e mesme të lartë, veçanërisht për djemtë (84 për qind). Shkalla e vijueshmërisë në mesin e fëmijëve që jetojnë në komunitetet Rom dhe Ashkali është më e ulët, veçanërisht për shkollën e mesme të ulët dhe të mesme të lartë (përkatesisht rreth 60 për qind dhe 30 për qind) ⁸¹.

Dallime të rëndësishme mund të vërehen midis vajzave dhe djemve, ku më shumë vajza sesa djem demonstron aftësi themelore të leximit, dhe më shumë djem sesa vajza që tregojnë aftësi themelore të numërimit; kjo mund të jetë rezultat i stereotipave të bazuara në gjini në arsim. Dallimet gjithashtu mund të vërehen midis fëmijëve që i përkasin komuniteteve të ndryshme (Shiko Tabelën 10 dhe Tabelën 11). Vetëm vajzat egjiptiane i afrohen popullsisë së përgjithshme të studimit në lidhje me aftësitë themelore të leximit (37.3 % kundrejt 41.7 %).


Tabela 10. Përqindja e fëmijëve të moshës 7 - 14 vjeç që demonstron aftësi themelore të leximit



⁸⁰ Po aty.

⁸¹ Po aty.

Tabela 11. Përqindja e fëmijëve të moshës 7 - 14 vjeç që demonstrojnë aftësi themelore të llogaritjes



(Burimi: Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) për komunitetet Rom dhe Ashkali në Kosovë të realizuar në 2019-2020) ⁸²

Shkalla e nxënësve jashtë shkollës

Sipas MICS një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve të moshës shkollare fillore që u përkasin komuniteteve Rom dhe Ashkali mbeten jashtë shkollës: 12.3% e vajzave rome të Kosovës, 15.9% e djemve rom të Kosovës; 17.7% e vajzave ashkali të Kosovës, 14.7% djem ashkali të Kosovës. Ndërsa pabarazitë gjinore dhe komunitare janë relativisht të vogla, dallimet kryesore u identifikuan midis familjeve më të pasura dhe më të varfra: Ndërsa 17.2% e fëmijëve të 60 përqindëshit më të varfër të familjeve rome, ashkali dhe egjiptianëve janë jashtë shkollës, vetëm 3.7% të fëmijëve nga 40% e familjeve më të pasura janë në të njëjtin pozicion. Ekziston edhe një dimension gjinor i çështjes: ndërsa më shumë vajza nga familjet më të varfra janë jashtë shkollës (18.4%) sesa djemtë (15.9%), situata përmbysset në familjet më të pasura - 1.8% e vajzave dhe 5.2% e djemve janë jashtë shkollës në këtë popullatë.

Në popullsinë e përgjithshme, vetëm 2.1% e fëmijëve të moshës së shkollës fillore janë jashtë shkollës (1.7% e vajzave dhe 2.4% e djemve), ku praktikisht të gjithë ata jetojnë në familje të vendosura në kuintilin më të varfër të familjeve - në familje të tilla, përqindja e fëmijëve jashtë shkollës rritet në 7.3% (5.4% e vajzave, 9.1% e djemve), ndërsa në katër kuintilët e tjerë, mbetet nën 1%.

Është e qartë se ekziston një lidhje midis varfërisë, përkatësisë në komunitet dhe vijimit të shkollës, dhe vëmendje duhet t'i kushtohet shkaqeve strukturore të përjashtimit socio-ekonomik, përfshirë modelet historike të diskriminimit, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje për këtë problem të

⁸² MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ASK, 2020.

rëndësishëm. Pas sukseseve në trajtimin e atyre që braktisën shkollën, duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme institucionale për të identifikuar fëmijët jashtë shkollës (të cilët mund të mos kenë ndjekur kurrë shkollën në radhë të parë), dhe për të ndërmarrë hapa për të stimuluar njëkohësisht ndjekjen e tyre në shkollë dhe për të lehtësuar gjendjen shoqërore dhe gjendjen ekonomike të familjeve të tyre, në mënyrë që ta bëjnë të qëndrueshme ndjekjen e shkollës.

Gjuha e mësimdhënies

Nxënësit nga komuniteti rom përballen me një sfidë shtesë që mund të pengojë arsimimin e tyre. Sipas MICS7, vetëm 46 përqind e fëmijëve nga komuniteti rom përdorin të njëjtën gjuhë në shtëpi që përdoret nga mësuesit në shkollë (në kontrast me 96.2 përqind të fëmijëve nga komuniteti ashkali i Kosovës, 100 përqind e fëmijëve nga komuniteti egjiptian i Kosovës dhe 98.6 përqind e popullsisë së përgjithshme). Kjo me sa duket është për shkak të shumë familjeve romë të Kosovës që përdorin kryesisht gjuhën romë si gjuhë komunikimi, si dhe familjet e kthyera që përdorin gjuhën kryesore të vendit të mëparshëm të zhvendosjes si gjuhë komunikimi.

Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, si dhe Ligji për Arsimin Parauniversitar,⁸³ u garantojnë nxënësve të drejtën për të marrë arsim në gjuhën zyrtare sipas dëshirës së tyre, gjë që mund të lehtësohet, p.sh. krijimin e klasave shtesë me një prag më të ulët regjistrimi, ose me sigurimin e transportit të subvencionuar në një zonë ku ofrohet një shkollim i tillë. Për më tepër, për të promovuar pjesëmarrjen, komunat kanë një detyrim të organizojnë transport për nxënësit në arsimin e detyrueshëm në kushte të caktuara. Institucionet përgjegjëse duhet të përpiqen të identifikojnë nxënësit që nuk ndjekin shkollën ose që nuk marrin udhëzime në një gjuhë zyrtare sipas dëshirës së tyre, për shkak të çështjeve të lidhura me transportin.

Arsimi i lartë

Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, MASHTI ka miratuar Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2016 për Aplikimin e Masave Afirmative dhe Kuotave për Regjistrimin e Kandidatëve nga Komunitetet Jo-Shumicë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë. Ky udhëzim rezervon 12 përqind të vendeve në institucionet publike të arsimit të lartë për studentët që i përkasin komuniteteve jo shumicë, përfshirë studentët nga komunitetet romë të Kosovës, ashkali të Kosovës dhe egjiptianët e Kosovës. Që kur udhëzimi ka hyrë në fuqi, numri i studentëve nga komunitetet romë, ashkali të Kosovës dhe egjiptianët e Kosovës është rritur ndjeshëm. Aktualisht, ka studentë që studiojnë në universitetet publike, përveç studentë në institucionet private të arsimit të lartë. Një numër studentësh po marrin bursa, dhe disa komuna, përfshirë Ferizajin dhe Gjakovën, ofrojnë një numër të vogël të bursave për studentët e universiteteve nga komunitetet romë, ashkali të Kosovës dhe egjiptianët e Kosovës me vendbanim të përhershëm në territoret e tyre.

⁸³ Ligji nr. 04/L-032 për arsimin para universitar në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 17, 16 shtator 2011) <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770&langid=1>

2.2. Punësimi dhe mirëqenia sociale

Objektivi Strategjik 2: Rritja e qasjes së barabartë në punësim të qëndrueshëm si dhe ulja e varfërisë të komuniteteve Rom dhe Ashkali

Objektiva Strategjike 2 synon përmirësimin e pozitës së komuniteteve Rom dhe Ashkali në fushën e punësimit dhe të mirëqenies sociale.

Qasja në punësim, skemat e mbrojtjes sociale dhe shërbimet sociale kontribuojnë në përmirësimin e mirëqenies ekonomike dhe sociale të individit dhe komunitetit. Qasja e barabartë e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në punësim, në shërbime të punësimit, në mundësi për zhvillim profesional, dhe në skemat e shërbimeve sociale duhet përmirësuar, si dhe duhet siguruar që këto të reflektojnë nevojat specifike të këtyre dy komuniteteve të synuara. Aktivizimi në treg të punës dhe krijimi i mundësive të reja për zhvillim profesional, dhe jo varësia nga skemat e ndihmave sociale, mbeten synim kryesor në drejtim të përmirësimit të mirëqenies ekonomike dhe sociale të këtyre komuniteteve.

Punësimi i pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali në institucionet publike të Republikës së Kosovës nuk përbën vetën një çështje politike por një domosdoshmëri dhe një obligim ligjor që rezulton nga parimet universale të trajtimit të barabartë, të të drejtës për punësim dhe të mos diskriminimit.

Mekanizmat për stimulimin e punësimit dhe zbutjes së varfërisë tek komunitetet Rom dhe Ashkali

Për të arritur Objektivin Strategjik 2, Qeveria do të ndjek dhe të promovojë një sërë politikash qendrore dhe lokale, por gjithashtu do të nxisë dhe stimulojë përfshirjen e sektorit privat në zbutjen e papunësisë dhe varfërisë të pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve Rom dhe Ashkali.

Në nivelin qendror, zbatimi i politikave të punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali, sipas statistikave të cekur më poshtë, lejon hapësirë për të rritur numrin e të punësuarve nga komunitetet Rom dhe Ashkali, mirëpo efekt edhe më i gjerë mund të arrihet edhe përmes miratimit dhe zbatimit të infrastrukturës së legjislacioni duke përfshirë edhe kodet e etikës që ndalojnë, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit në shoqërinë kosovare.

Në nivelin lokal statistikave e prezantuara më poshtë, gjithashtu informojnë se ka mjaft hapësirë për përmirësim të situatës nga vetë institucionet lokale që mund të përmirësojnë normën e punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali. Gjithashtu, për zvogëlimin e papunësisë dhe

varfërisë së komuniteteve Rom dhe Ashkali duhet të angazhohen edhe QPS-të dhe Zyrat Komunale të Punësimit në iniciativë të përbashkët, ku QPS-të mund të shpërndajnë informacione për mundësitë e punësimit dhe pranuesit e skemave sociale të regjistrohesh si punëkërkuar aktivë në zyrat komunale për punësim, në mënyrë që t'u krijohet qasja në informacione dhe mundësi të punësimit. Këto institucione komunale gjithashtu duhet të mbështeten për të ofruar programe të aftësimit profesional për të gjithë përfituesit e skemave sociale, me fokus në përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali.

Përveç angazhimit në sektorin publik, në nivel qendror dhe lokal mund të krijohen politika për nxitjen dhe përkrahjen e sektorit privat në punësimin e qytetarëve Rom dhe Ashkali. Politika relevante mund të përfshijnë politika lehtësuese të tatimit për bizneset që punësojnë pjesëtar të komuniteteve Rom dhe Ashkali; shtesë kësaj ose si alternativë mund të zbatohen masa lehtësuese tatimore për bizneset që operojnë programe të aftësimit profesional për anëtarë të komuniteteve Rom dhe Ashkali. Angazhimi i anëtarëve të komuniteteve në marrëdhënie afatgjatë pune, në njërin anë do të ndihmojë direkt në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike për familje të komuniteteve, dhe në anën tjetër do të lehtësonte skemat sociale në afat të gjatë dhe do të ndihmonte regjistrimin e punëtorëve të rregulltë nga ana e bizneseve, për të përfituar nga lehtësimet tatimore. Kostoja e lehtësimit të masave tatimore në afat të gjatë do të kalonte konsiderueshëm koston e skemave sociale nga të cilat familjet e komuniteteve varen përderisa asnjë anëtar nuk është i punësuar në marrëdhënie të rregulltë pune.

Për të arritur Objektiven Strategjike 2, teoria e ndryshimit parasheh: 1) që me përcjelljen e normave të caktuara të punësimit të komuniteteve Rom dhe Ashkali në nivel qendror, dhe normave të caktuara edhe sipas përqendrimit të demografisë në nivel komunal, punësimi i komuniteteve Rom dhe Ashkali në sektorin publik do të maksimizohet; 2) që me regjistrimin e pjesëtarëve të komunitetit Rom dhe Ashkali si punëkërkuar aktivë dhe programeve të aftësimit profesional të specializuar për këto komunitete do të përmirësohet qasja dhe pjesëmarrja e këtyre komuniteteve në treg të punës; dhe 3) që përmes sensibilizimit dhe ndërgjegjësimin të komuniteteve të synuara, por sidomos edhe të punëdhënësve të sektorit privat, si dhe masave stimuluese (si lehtësim i tatimit në punësim apo aftësim profesional të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali nga ana e punëdhënësve) do të rritet mundësia dhe pjesëmarrja në treg të punës për komunitetet e synuara.

Duke ndjekur këtë logjikë, për të arritur Objektiven Strategjike 2, janë paraparë këto objektiva specifike:

2.1 Objektiva Specifike 1: Përmirësimi i qasjes në pjesëmarrje të barabartë në treg të punës përmes sistemimit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali në zyrat komunale për punësim dhe programeve të aftësimit profesional;

2.2 Objektiva Specifike 2: Rritja e pjesëmarrjes dhe mundësive në punësim përmes sensibilizimit të punëdhënësve dhe pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali si dhe masave stimuluese për punëdhënës;

2.3 Objektiva Specifike 3: Përfshirja e komuniteteve Rom dhe Ashkali në punësim në institucione publike qendrore dhe lokale, sipas kuotave të përcaktuara nga ligji;

Punësimi

E Drejta për punë është një nga të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura dhe të garantuara me Nenin 49 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

Zbatimi i së drejtës për punë, si një standard i të drejtave të njeriut, shkon përtej mbrojtjes dhe sigurimit të punësimin si një mjet i mbijetesës apo të mirëqenies materiale, por gjithashtu përfshin kultivimin e marrëdhënieve të barazisë dhe të pjesëmarrjes në shoqëri. Treguesit në këtë drejtim përbëjnë jo vetëm mungesën e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në procedurat e aplikimit, por edhe mungesën e përpjekjeve që një shtet ka marrë për të garantuar qasjen në punësim për të gjitha grupet e popullsisë së përgjithshme të shtetit dhe përfaqësimin e barabartë të të gjitha grupeve të popullsisë në punësim në sektorin publik dhe atë privat.⁸⁴

Pavarësisht kornizës ligjore që siguron përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali, këto komunitete janë ndjeshëm të nën-përfaqësuara në punësim në institucione publike.

Papunësia është një ndër sfidat për Kosovën, por niveli i lartë i papunësisë ndjehet edhe më shumë te komunitetet rom dhe ashkali, ku niveli i papunësisë është shumë më i lartë.

Papunësia në Kosovë vazhdon të mbetet në një nivel tejet të lartë. Të dhënat e fundit për papunësinë të publikuara nga ASK bëjnë të ditur se shkalla e papunësisë në Kosovë në pjesën e parë të vitit 2021 ishte 25.8%.

Papunësia vazhdon të jetë më e theksuar është te femrat me 29.7%, krahasuar me meshkujt, 24.2%. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grup moshat 15-24 vjeçare me 48.6%, thuhet në publikimin e ASK.⁸⁵

Statistikat na tregojnë që papunësia në përgjithësi është shumë e lartë në Kosovë. Anketa më e fundit i Fuqisë Punëtore (AFP) e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), botuar në dhjetor 2019 tregon për një pjesëmarrje të ulët në tregun e punës 40.5% (ASK, AFP 2019), veçanërisht në mesin e të rinjve dhe femrave, dhe një shkallë e lartë e papunësisë (25.7%). Rreth dy të tretat e popullsisë aktive në moshë pune janë joaktive (59.5%). Shkalla e papunësisë së të rinjve (15-24 vjeç) është mbi 49.4%. Shkalla e NEET (Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo trajnim) për të rinjtë 15-24 vjet është rreth 32.7%.⁸⁶

⁸⁴ Koncept Dokument, i miratuar në mbledhjen e 22 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 04/22 03.04.2015, fq. 10


⁸⁵ Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP), TM1 2021, ASK, 2021.

⁸⁶ Raporti i Vlerësimit Afatmesëm 2017-2019 mbi Zbatimin Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021, Zyra për Qeverisje të Mirë, Shtator – 2020.

Aktualisht, niveli i punësimit i komuniteteve Rom dhe Ashkali është shumë i ulët (edhe në krahasim me komunitetet tjera), ndërsa përfshirja në skema e shërbime sociale është më e madhe po prapë mbetet e kufizuar. Statistikat e publikuara për gjendjen e punësimit të komuniteteve Rom dhe Ashkali janë të bazuara, kryesisht, në anketa që nuk e kanë tregun e punës si fokus të hulumtimit dhe nuk përdorin metodologji dhe definicione konvencionale, prandaj si të tilla ato duhet të konsiderohen vetëm indikative dhe nuk janë (plotësisht) të krahasueshme me indikatorët më lart, në nivel të vendit. Megjithatë, statistikat ekzistuese tregojnë se shkalla e papunësisë të këtyre komuniteteve është dukshëm më e ulët krahasuar me të gjitha komunitetet tjera.

Situata socio-ekonomike e pjesëtarëve të tri komuniteteve dhe qasja e tyre në punësimin e sektorit privat mbetet sfidë. Sipas Pasqyrës së Komunitetit Rom, ashkali dhe Egjiptas 2020, dhe të dhënave të zyrave komunale të punësimit (për 19 komuna) përafërsisht 1622 anëtarë të komunitetit rom, 1609 ashkali dhe 664 egjiptas janë regjistruar si punëkërkes aktivë. Sipas informatave të ofruara nga qendrat për mirëqenie sociale në këto komuna, 701 familje rome (që përbëhen nga rreth 3500 individë), 1320 familje ashkali (që përbëhen nga rreth 6800 individë) dhe 385 familje egjiptase (që përbëhen nga rreth 1700 individë) janë përfitues të ndihmës sociale.⁸⁷ Bazuar në të dhënat e anketës së tregueseve të shumëfishtë për Kosovën për komunitetet Rom dhe Ashkali është identifikuar një numër i fëmijëve të angazhuar në punë të ndryshme që pa dyshim ndikon negativisht në arsimimin dhe shëndetin e tyre.⁸⁸ Bazuar në MICS për komunitetet Rom dhe Ashkali të realizuar në vitet 2019-2020 nga ASK, kuptojmë se 1 në 14 fëmijë nën 5 vjeç që jetojnë në komunitetet Rom dhe Ashkali në Kosovë janë nën peshë⁸⁹. Dukuria e nënpeshës zvogëlohet me pasurinë e ekonomisë familjare dhe nivelin e arsimimit të nënës.

Tabela 12. Punësimi i fëmijëve



(Burimi: Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) për komunitetet Rom dhe Ashkali në Kosovë të realizuar në 2019-2020)⁹⁰

Nga pikëpamja e politik bërjes mund të identifikohen dy lloj mekanizmesh/masash kyçe për promovimin e punësimit të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve.

⁸⁷ Pasqyrë e Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Kosovës, OSBE, 2020.

⁸⁸ Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ASK, 2020.

⁸⁹ Po aty.

⁹⁰ MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ASK, 2020.

- Korniza ligjore që rregullon përfaqësimin në punësim të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në institucionet publike
- Masat aktive të tregut të punës të realizuara nga MFPT (në bashkëpunim me MPB dhe/ose donatorët)

Neni 61 i Kushtetutës, u garanton komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre të drejtën për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu veçanërisht në shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin e qeverisjes së administratës publike.⁹¹

Kjo e drejtë e komuniteteve dhe pjesëtarëve për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike shtjellohet edhe në nene tjera të Kushtetutës si dhe në ligje të ndryshme.

Që nga viti 2010, Ligji 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcakton përfaqësimin në shërbimin civil për komunitetet jo shumice përmes kuotës minimale prej 10 për qind në nivel qendror dhe përfaqësimit proporcional me përbërjen demografike në nivel komunal.⁹²

Ligji për zyrtarët publikë,⁹³ i cili shfuqizon Ligjin për Shërbimin Civilë, në Nenin 9 përcakton si në vijim:

“Në institucionet publike qendrore, minimum 10% e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë.”

Obligimi i kuotës së punësimit prej 10% vlen për Zyrtarë publikë, që në kuptim të Ligjit për zyrtarët publikë përfshinë nëpunësit e Shërbimit Civil (nëpunësit civil); nëpunësit e Shërbimit Publik; nëpunësit e Kabinetit; dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës. Po ashtu, Ligji për zyrtarët publikë përfshinë dhe zbatohen parimet e përcaktuara me këtë ligj edhe nëpunësit civilë me status të veçantë: Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues si dhe nëpunësit e administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sipas Raportit të OSBE -së 2017 për Përfaqësimin e Komuniteteve në Shërbimin Civil, komunitetet Rom dhe Ashkali të Kosovës ishin shumë të nën përfaqësuar në shërbimin civil si në nivelin qeveritar ashtu edhe në atë komunal. Nga gjithsej 3,480 nëpunës civilë në institucionet e

⁹¹ Kushtetuta, Neni 61.

⁹² Rregullorja 04/2010 për Procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumice në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, përcaktonte që institucionet të zbatojnë së paku 6 nga 14 masat e parapara aty që përfshijnë: komunikimin; masat pozitive vepruese; praktikën në punë, bursat, dhe programet e trajnimit për aplikuesit; trajnimet për shërbyesit civil të komuniteteve jo shumicë; punëtoritë kundër diskriminimit; dhe bashkëpunimin ndër-institucional.

⁹³ Ligji nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë (GZ, Nr. 8, 11.03.2019), Neni 9.

nivelit qeveritar të vlerësuar në raport, vetëm një burrë ishte ashkali (0.03 përqind), një burrë ishte egjiptian (0.03 përqind) dhe katër gra dhe një burrë ishin rom (0.14 për qind).

Në nivelin komunal, situata ishte pak më e mirë se sa në atë qendror: 16 rom, 14 ashkali, dhe 12 egjiptianë punuan në shërbimin komunal. Të dhënat po ashtu tregojnë se në nivel komunal, për tu plotësuar normat për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas, duke përfshirë edhe përfaqësimin demografik, duhet që numri i nëpunësve nga këto komunitete së paku të dyfishohet.⁹⁴

Duke ju referuar të dhënave të Ministrisë së Administratës Publike (qershor 2019), punësimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në institucione publike është si në vijim:

Në nivel të administratës së komunave nga 6249 të punësuar, 16 janë ashkali, 10 egjiptian dhe 9 rom.

Të punësuar në arsim në komuna nga 27204 të punësuar në total, pjesëmarrja e tri komuniteteve është si në vijim: 55 janë ashkali, 2 egjiptian dhe 38 rom.

Ndërsa nga 5971 të punësuar në sektorin e shëndetësisë në komuna, 5 janë ashkali, 7 egjiptian dhe 12 rom.

Në nivelin qendror, gjegjësisht në ministritë dhe institucionet tjera të nivelit qendror nuk është një pjesëmarrje e duhur e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Nga 45779 të punësuar në total në këto institucione të nivelit qendror (që përfshinë shërbimin civil dhe publik) janë të punësuar si në vijim: 35 janë ashkali, 36 egjiptian dhe 72 rom.

Nga ajo që u cek më sipër, duke marrë parasysh numrin e përgjithshëm të punësuarve në institucione publike, të nivelit qendror dhe lokal (që përfshinë të gjithë sektorët, administratën, arsimin, shëndetësinë etj.), nga 85202 të punësuar në këto institucione, 297 prej tyre janë të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian (131 rom, 111 ashkali, dhe 55 egjiptian).

Nga statistikat e mësipërme shohim që përfshirja e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në institucione publike si në nivelin komunal ashtu edhe në atë qendror është në nivele të papërfillshme. Kjo situatë është, siç e cekem më lartë rrjedhojë e mungesës së arsimimit dhe kualifikimit të nevojshëm profesional të këtyre komuniteteve, mungesës së besimit të këtyre komuniteteve ndaj institucioneve publike, por edhe diskriminimi i fshehtë i kësaj pjese të popullsisë.

Mirëqenia sociale

Mbrojtja sociale, ulja e varfërisë dhe përfshirja e grupeve të përjashtuara në jetën sociale ekonomike të vendit, mbeten prioritetet e MFPT/DPSF, ku synojnë të sigurojnë mirëqenien e popullatës, përmes zgjerimit dhe ngritjes së cilësisë së skemave të mbrojtjes, shërbimeve sociale të ndërlidhura me Programin e Qeverisë 2021-2025.

⁹⁴ Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë, OSCE, 2017.

Shumica e pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali jetojnë në varfëri ekstreme dhe vazhdojnë të ndeshen me kushte të vështira të jetesës. Situata është posaçërisht e vështirë për 20% të më të varfërve të këtyre komuniteteve dhe familjeve që jetojnë në zonat rurale.⁹⁵

Sipas raportit: “Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës 2012-2015”, të publikuar në muajin prill 2017, nga Banka Botërore dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, 17.6 përqind e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë, me më pak se 1.82 euro në ditë, ndërsa 5.2 përqind e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë së skajshme, me më pak se 1.30 euro në ditë. Krahasuar me vitin paraprak kemi një rënie të nivelit të varfërisë prej 3.5 pikë të përqindjes. Niveli i varfërisë mbetet i lartë sidomos për grupe siç janë: familjet që banojnë në vendbanimet rurale, familjet me më shumë anëtarë, ku shkalla më e lartë e varfërisë është gjetur tek familjet me shtatë e më shumë anëtarë, familjet që burim kryesor të të ardhurave kanë ndihmën sociale, familjet me burim kryesor të të ardhurave nga puna me mëditje, familjet që burim kryesor të të ardhurave kanë pensionet, të punësuarit në punë të rastësishme, personat me aftësi të kufizuara, nxënësit/studentët, të papunësuarit, familjet që kryesohen nga femrat, individët me shkallë të ulët të arsimimit, individët që nuk e kanë përfunduar shkollën fillore fëmijët si dhe familjet me 3 e më shumë fëmijë.

Statistikat, po ashtu, na tregojnë që papunësia në përgjithësi është shumë e lartë në Kosovë. Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP) e ASK, botuar në dhjetor 2019 tregon për një pjesëmarrje të ulët në tregun e punës 40.5% (ASK, AFP 2019), veçanërisht në mesin e të rinjve dhe femrave, dhe një shkallë e lartë e papunësisë (25.7%). Rreth dy të tretat e popullsisë aktive në moshë pune janë joaktive (59.5%). Shkalla e papunësisë së të rinjve (15-24 vjeç) është mbi 49.4%. Shkalla e NEET (Të rinj që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo trajnim) për të rinjtë 15-24 vjet është rreth 32.7%.⁹⁶

Me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare⁹⁷ është përcaktuar dhe rregulluar ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë⁹⁸ dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë. Njëkohësisht, me këtë ligj është rregulluar roli dhe përgjegjësitë e mekanizmave përkatëse për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, gjegjësisht ministrisë përkatëse (MFPT)⁹⁹ dhe departamentit përkatës (Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes-DPSF) në kuadër të kësaj

⁹⁵ Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare 2017-2021, Qeveria e Republikës së Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë Prishtinë, prill 2017, fq. 20.

⁹⁶ Raporti i Vlerësimit Afatmesëm 2017-2019 mbi Zbatimin Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021, Zyra për Qeverisje të Mirë, Shtator – 2020.

⁹⁷ Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare (Gazeta Zyrtare nr. 12, 01 maj 2007) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-081 (Gazeta Zyrtare, nr. 5, 05 prill 2012)

⁹⁸ Person në nevojë në kuptim të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak: 1. se është fëmijë pa përkujdesje prindore; 2. se është fëmijë me sjellje asociale; 3. se është delikuent i mitur; 4. të marrëdhënieve të çrregulluara në familje; 5. të moshës së shtyer; 6. të sëmundjes trupore ose aftësive të kufizuara fizike; 7. të aftësive të kufizuara mendore; 8. të sëmundjes mendore; 9. të rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi; 10. të dhunës në familje; 11. të trafikut të qenieve njerëzore; 12. të varësisë nga alkooli ose drogat; 13. të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu; 14. ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë.

⁹⁹ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, sipas përbërjes së Qeverisë në vitin 2021.

ministrive si dhe roli dhe përgjegjësitë e Këshillit të përgjithshëm të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Komunave, Qendrave për Punë Sociale dhe Sektorit Jo-Qeveritar .

MFPT/DPSF është përgjegjëse për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë dhe siguron që të gjithë banorët e Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbimet sociale dhe familjare pa dallim.

Ministria është përgjegjëse për zhvillimin e politikave, hartimin e legjislacionit, standardeve, planeve strategjike për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për popullatën e Kosovës si dhe siguron zbatimin e duhur nga ana e komunave dhe organizatave të tjera që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

Shërbimet sociale ofrohen kryesisht në nivel lokal. Komponentët kryesore të sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në nivel lokal përfshijnë Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përmes Qendrave për Punë Sociale (QPS), të cilat me decentralizim nga viti 2009 kanë kaluar në kompetenca të komunave dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për të gjithë qytetarët e Kosovës. Përveç institucioneve publike të lartpërmendura një rol të rëndësishëm kanë edhe OJQ-të.

QPS-të, përveç tjerave, bëjnë vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve pas pranimit të kërkesës për asistencë sociale. Gjithsej 40 QPS-të e shpërndara nëpër 38 komunat e Kosovës sigurojnë mbulimin gjeografik të tërë vendit. Gjithashtu, përmes programeve të donatorëve për asistencë teknike janë mbajtur trajnime për përmirësimin e menaxhimit dhe planifikimit të burimeve në nivelin lokal

Mandati për ofrimin e shërbimeve sociale nga ana e komunave përcaktohet me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (LVL).¹⁰⁰ Neni 17 i LVL-së radhitë kompetencat vetanake të komunave, duke përfshirë edhe ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimi familjar, përkujdesi ndaj fëmijëve, përkujdesi ndaj të moshuarve, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e pagave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale.

Mirëmbajtja, respektimi dhe zbatimi i standardeve si dhe i disiplinës profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare është përgjegjësi e Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare (KPSHSF). Ky organ gjithashtu është përgjegjës edhe për licencimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare të sektorit qeveritar dhe jo-qeveritar.

Sistemi i kujdesit rezidencial ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve 24-orësh për personat e moshuar pa përkujdesje familjare dhe personat me aftësi të kufizuara mendore. Këtë sistem e përbëjnë dy institucione të mëdha: Shtëpia për Personat e Moshuar pa Përkujdesje Familjare (SHPMF) në

¹⁰⁰ Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare, Nr. 28, 04 qershor 2008). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Prishtinë dhe Instituti Special në Shtime (ISSH), si dhe në 13 shtëpi të Komunitetit me shtrirje në disa komuna të Kosovës.

Strehimoret për viktimat e trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje kryesisht drejtohen nga OJQ-të. Strehimoret që drejtohen nga OJQ-të, mbështetën nga subvencione nga MFPT në bazë të projekteve, ndërsa një pjesë të fondeve e sigurojnë nga bashkëfinancimet me komuna dhe donatorë.

Përfshirja e ulët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në skemat e mirëqenies sociale dhe shfrytëzimi i pamjaftueshëm i shërbimeve sociale vështirëson zbutjen e varfërisë në mesin e këtyre komuniteteve dhe kjo paraqet sfidë shumë serioze.

Qeveria e Kosovës i ka identifikuar grupet në vijim si më të rrezikuara, që e ndjejnë përjashtimin më shumë se të tjerët dhe të cilët janë prioritet i politikave sociale në Kosovë: të papunësuarit afatgjatë, fëmijët dhe të rinjtë e pa favorizuar, posaçërisht vajzat nga viset rurale dhe fëmijët e komuniteteve, femrat nga viset rurale, nënat vetushqyese, komunitetet (Rome, Ashkali, Egjiptian) të cilët përveç shkallës më të lartë të papunësisë dhe varfërisë kanë nivel të ulët të shkollimit dhe shkallën më të lartë të analfabetizimit dhe personat me aftësi të kufizuara - shumica e të cilëve nuk kanë qasje fizike në objektet shëndetësore dhe arsimore - dhe familjet e tyre të cilat janë ofruesi kryesor i përkujdesjes për këta persona.

MFPT ne vazhdimësi angazhohet ne mirëqenien e te gjithë qytetareve te Republikës se Kosovës pa dallim etnie. Sistemi i mbrojtës sociale në Kosovë bazohet në: skemat e përfitimeve (kesh) dhe shërbimet profesionale. Sistemi në përgjithësi financohet nga Buxheti i Shtetit për nivelin qendror dhe lokal.

Programet e përfitimeve nga të gjitha skemat dhe shërbimet mbulojnë rreth 16.% të popullsisë ne Kosovë.

Politikat e MFPT janë të orientuara në zhvillimin e programeve të cilat ndihmojnë familjet dhe individët të rrezikuar nga varfëria dhe përjashtimi social.

Programet kryesore që zbatohen janë të fokusuar në realizimin e përfitimeve dhe shërbimeve të paraqitura ne skemat ekzistuese:

1. Programi i mbështetjes së familjeve të varfra, që është zbatuar përmes Skemës së Ndihmës Sociale (SNS);
2. Programi i mbështetjes së familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, që është zbatuar përmes Skemës së Përkrahjes së Familjeve me Fëmijë të Aftësisë së Kufizuar;
3. Programi i mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror dhe të braktisur, që është zbatuar përmes strehimit familjar;
4. Programi i mbështetjes së viktimave të dhunës dhe trafikimit, që është zbatuar përmes kontraktimit dhe blerjes së shërbimeve nga OJQ-ët;

5. Programi i ofrimit të shërbimeve rezidenciale për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuar, që është zbatuar përmes ofrimit të shërbimeve 24 orësh në institucionet rezidenciale;
6. Programi i ofrimit të shërbimeve ditore dhe në familje për fëmijë dhe të rritur, që është zbatuar në bashkëfinancim të projekteve të OJQ-ve nga MFPT donatorët apo komuna.

Sa i përket ofrimit të ndihmave sociale për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas, të dhënat janë si në vijim:

1. 2,992 familje me 14, 051 anëtare nga komunitetet Rome, Ashkali, Egjiptian janë përfitues të SNS. Edhe pse sipas të dhënave të regjistrimit civil, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas paraqesin rreth 2% të popullsisë së Republikës së Kosovës, këto të dhëna tregojnë se këto komunitete paraqesin rreth 11.5% të të gjitha familjeve dhe anëtarëve përfitues të SNS në Republikën e Kosovës. SNS u dedikohet të gjitha familjeve të varfra, pa dallim etnie, gjuhe, moshe, gjinie etj. Shuma mujore e ndihmës sociale për një familje përcaktohet sipas numrit të anëtarëve të familjes dhe kostos së çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit;
2. 60 EURO është shuma minimale (familja me 1 anëtare);
3. 180 EURO është shuma maksimale (familja me 15 anëtare);
4. Përveç ndihmës bazë, familja që është shfrytëzuese e ndihmës sociale për çdo fëmijë të moshës 0-18 vjeç merr edhe nga 5 Euro në muaj si formë e shtesës për fëmijë, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit të tyre;
5. SNS menaxhohet nga QPS, vendimmarrja në përzgjedhjen e rasteve është nga QPS ndërsa hartimi politikave, sigurimi i buxhetit nga MFPT.
6. Sipas të dhënave nga baza e DPSF/MFPT, ndihmën sociale e kanë shfrytëzuar 25.679 familje, me 103, 189 anëtarë të familjes, në gjithë Republikën Kosovës;
1. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës për çdo vit ka ndarë nga 4.5 milion euro për subvencionimin e një sasive të energjisë së shpenzuar elektrike për shfrytëzuesit (familjet) në SNS. Kjo shlyerje behet sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit në mes MPMS-MF-KEK, për të gjithë qytetaret e Kosovës që realizojnë ndihmën sociale nga 400 KËH në muaj. Në këtë rast nga komunitetet Rome, Ashkali, Egjiptian, janë 2,992 familje që subvencionohen për energji elektrike.
7. Po ashtu 70 familje nga komunitet Rome, Ashkali, Egjiptian kanë përfituar nga Skema emergjente, ndihmat momentale, ndihmat e njëhershme, nga 100-300 euro.
8. Mbështetja përmes skemës së familjeve për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme 1-18 vjeç
9. 112 fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme të moshës 1-18 vjeç nga familjet e komuniteteve Rome, Ashkali, Egjiptian, përfitojnë nga 100 euro në muaj, ky numër mund të ndryshoj nga muaji në muaj. Përmes kësaj skeme mbështeten familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të Përhershme. Numri total për të gjitha komunitetet në Kosovë është 2,496 fëmijë. Skema është publike, universale dhe e

financuar nga fondet publike. Aplikimi behet ne QPS-et përkatëse, vlerësimi nga eksperte te komisioni mjekësor, ndërsa buxheti sigurohet nga MFPT.

10. Skema e përkrahjes Materiale Familjeve qe kanë fëmijë me aftësi të kufizuara te përhershme rregullohet me Ligj.¹⁰¹

- Nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, Fëmijë në Strehim Familjare brenda familjes janë 50 fëmijë me pagesë mujore 100-euro në muaj.

- Persona me aftësi të kufizuara dhe persona të moshuar nga komuniteti Rom dhe Ashkali, 8 persona janë të vendosur në Institutin Special në Shtime (ISSH) dhe 3 persona në Shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare (SHMPMF).

Benificionet tjera të familjeve në SNS:

- Heqja e shpenzimeve të regjistrimit të semestrave ne Universitetin publik;

- Projektet e ndryshme të DPP në punët publike;

- Ndihamat e ndryshme të shoqatave vendore e ndërkombëtare;

- Shërbime primare mjekësore;

- Lirimi nga taksa në disa komuna.

Si pjesë e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Pakos së Ringjalljes Ekonomike në vitin 2021 janë zbatuar disa masa që kanë ofruar mbështetje. Masat e pakove kanë qenë të fokusuara në mbështetjen e familjeve në asistencë sociale me pagesa të dyfishta, rritje të vlerës së asistencës sociale, pagesës së shtesave për disa skema sociale dhe pensionale.

Në kuadër të zbatimit të masës 3.2 – Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, me propozimin e MFPT është aprovuar vendimi nga kabineti ku kanë përfituar pagesa shtesë në vlerë të mbështetjes financiare prej 100 € (njëqind euro), të gjithë përfituesit e skemave pensionale për muajin Nëntor 2021, dhe Vendimi në dyfishimin e pagesës mbi vlerën bazë dhe të shtesave të aprovuara për përfituesit e skemës së ndihmës sociale për periudhën Nëntor-Dhjetor 2021.

Po ashtu në koordinimin e MFPT/DPSF dhe fondeve nga donatorët janë ofruar kuponë ushqimor në vlerë prej 60-70 euro në muaj për mbi 10,000 familje në ndihmë Sociale për 6 muaj për vitin 2021.

Masa 3.4 mbështetje financiare për OJQ-të dhe entitetet tjera që ofrojnë shërbime sociale për kategoritë e cënueshëm të shoqërisë përmes kuzhinave popullore. Programi i Qeverisë 2021-2025 synon rritjen e mirëqenies sociale dhe uljen e varfërisë nëpërmjet mbështetjes se grupeve të cënueshme dhe ristrukturimit të skemave sociale dhe pensionale, dizajnimin të skemave të reja

¹⁰¹ Ligji nr. 03/L-022 për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme (Gazeta Zyrtare, nr. 37, 10 shtator 2008).

sociale dhe pensionale. Është filluar me programin e shtesave për fëmijët, ku fëmijët nën moshën 2 vjeçare përfitojnë shtesa mujore në vlerë prej 20 euro në muaj, ndërsa fëmijët nën moshën 16 vjeçare do të përfitojnë shtesa mujore në vlerë prej 10 euro.

Në fushën e politikave sociale, shërbimeve sociale, skemën sociale, janë aprovuar dhe finalizuar disa dokumente të politikave dhe akte nënligjore në fuqi.¹⁰²

Sfidat me të cilat ballafaqohet komunitetet Rom dhe Ashkali janë:

- **Mungesa e kapaciteteve për ofrim të shërbimeve në nivel lokal.** Së pari, numri i ofruesve të shërbimeve në relacion me numrin e shërbimeve të ofruara është shumë i vogël.
- Mos vijimi i shkollës nga ana e fëmijëve të komunitetit Rom dhe Ashkali (Nëse fëmijët nuk e ndjekin shkollën, atëherë familjes i ndërpritet ndihma sociale dhe kjo gjë ndikon në rritjen e shkallës së varfërisë si dhe të përjashtimit të këtyre familjeve);
- Lëvizjet nga një banim në tjetrin;
- Mos kualifikimi adekuat i të rinjve të komuniteteve Rom dhe Ashkali për tregun e punës;
- Pa mundësia për të pasur qasje në nxjerrjen e dokumentacioneve të nevojshëm për përfitimin e ndihmës sociale. Mundësitë e këtyre grupeve për qasjen në shërbimet e ndryshme janë të kufizuara dhe dallojnë nga vendi ku jetojnë apo banojnë.
- Sfidat ekzistojnë në rritjen e kërkesave dhe numrit të qytetarëve dhe familjeve që kanë nevojë për mbrojtje sociale, shërbime sociale si rezultat i ndikimit të humbjes së të ardhurave dhe vendeve të punës nga Pandemia Covid 19.

¹⁰² Është finalizuar Projekt -Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare. Ligjit i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare synon të ndikojë në reformën e shërbimeve sociale dhe familjare, avancimin e formave të mbrojtjes për fëmijët, përfshirjen e shërbimeve sociale, rritjen e cilësisë dhe llogaridhënies dhe sigurimin e financimit të qëndrueshëm të shërbimeve sociale. Është finalizuar nga MFPT/DPSF dhe aprovuar nga Qeveria, Koncept Dokumenti për Reformimin e Skemës së Ndihmës Sociale. Ky Koncept Dokument (KD) synon të reformojë Skemën e Ndihmës Sociale për të përmirësuar ndikimin e skemës në zbutjen e varfërisë dhe zgjeruar mbulueshmërinë e familjeve të varfra në skemë. Është formuar grupi punues për hartimin e Ligjit të ri të SNS. Në Ligjin e ri nuk do të ketë Kategori I apo Kategori II të përfituesve, ndërsa mundësi aplikimi, përzgjedhjeje dhe përfitimi do të kenë të gjitha familjet të cilat konsiderojnë se janë të varfra dhe të cilat nuk kanë mundësi të plotësojnë nevojat bazike të konsumit të cilat do të përcaktohen me këtë ligj. Mungesa e qasjes për të plotësimin e nevojave bazë është e theksuar tek fëmijët, të rinjtë dhe familjet e komuniteteve Rom dhe Ashkali. Mbulimi i këtyre nevojave, si qasjes në ushqyerje thelbësore dhe kujdes mjekësor japin ndjenjë të qetësisë dhe kështu ofrojnë ndikim të madh në mirëqenien psiko-sociale.

2.3. Shëndetësia

Objektiva Strategjike 3: Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali dhe rritja e qasjes së barabartë në shërbime cilësore shëndetësore

Sikur në vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Juglindore, një numër i madh i familjeve të komuniteteve Rom dhe Ashkali jetojnë nën kufirin e varfërisë, me shume se 36% e tyre janë pjesë e këtij grupacioni.¹⁰³ Pa dyshim se varfëria ka ndikim negativ në shëndetin dhe jetëgjatësinë e njeriut, ku kjo dëshkohet edhe tek komunitetet Rom dhe Ashkali. Njerëzit me nivele të ulëta të të ardhurave janë veçanërisht të pambrojtur nga sëmundjet e përshpejtuara nga kualiteti i dobët si dhe mënyrat jo adekuate e të ushqyerit.

Disa dokumente strategjike, si edhe akterë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, janë munduar të adresojnë pjesërisht aspektet shëndetësore të komuniteteve. Strategjia përmes kësaj objektivë do kontribuojë në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali, duke bashkërenduar dhe zhvilluar programe që adresojnë problemet e pjesëtarëve të komuniteteve në fushën e shëndetësisë

Numri i ulët i vaksinimit nga pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali ka bërë që një pjesë e Strategjisë t'i kushtohet edukimit dhe vetëdijimit. Po ashtu, kujdes i veçantë i është kushtuar përmirësimit të qasjes në shërbime shëndetësore, sidomos për qëllime preventive në sëmundje kronike jo të transmetueshme nga të cilat vuajnë një masë signifikante pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali.

Për arritjen e Objektivës Strategjike 3 teoria e ndryshimit parasheh: 1) që pajisja me dokumente të identifikimit të të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali do të lejojë qasje të gjithë pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në shërbime publike shëndetësore; 2) që me ndërgjegjësimin e komuniteteve të synuara mbi rëndësinë e vaksinimit (sidomos pas pandemisë COVID-19), si dhe promovimin e ushqyeshmërisë së shëndetshme dhe metodat për parandalimin e sëmundjeve kronike jo të transmetueshme shëndeti i komuniteteve Rom dhe Ashkali do të përmirësohet në afat të gjatë; 3) që përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik të të gjitha niveleve për luftimin e trajtimit të barabartë të këtyre komuniteteve me shërbime të cilësisë së barabartë dhe zbatimi i një kodi të etikës që përmend qartazi këto principe dhe mosrespektimi i tyre rezulton në masa disiplinore, komunitetet e synuara do të marrin trajtim cilësor dhe të barabartë shëndetësor.

¹⁰³ Stubbs and Nestid, Child Poverty in Kosovo: Policy Options Paper & Synthesis Report. UNICEF. 2010.

Duke ndjekur këtë logjikë, për të arritur Objektiven Strategjike 3 janë paraparë këto objektiva specifike:

3.1 Objektiva Specifike 1: Përmirësimi i qasjes në shërbime shëndetësore cilësore për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali;

3.2 Objektiva Specifike 2: Përmirësimi i shëndetit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali përmes ndërgjegjësimit dhe promovimit të shëndetit;

3.3 Objektiva Specifike 3: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ndërgjegjësimit të stafit shëndetësor publik për trajtim të barabartë dhe eliminim të diskriminimit të komuniteteve Rom dhe Ashkali.

Pjesëtarët e Komuniteteve Rom dhe Ashkali vazhdojnë të vuajnë nga shëndeti i dobët për shkakun e qasjes së kufizuar në shërbimet parandaluese dhe kurative shëndetësore si dhe nga shkakun i të ushqyerit joadekuat dhe të pamjaftueshëm, gjë që kontribuon në shëndetin e dobët dhe jetëgjatësinë e shkurtër.

Pabarazia e qasjes në shërbimet e kujdesit shëndetësor zvogëlon mundësitë për shfrytëzim efikas të kapitalit njerëzor të këtyre komuniteteve, duke ndikuar në zvogëlimin e mundësive për të gjeneruar të ardhura si dhe për të ngritur mirëqenien e tyre.

Përfshirja dhe integrimi i komuniteteve Rom dhe Ashkali në marrjen e shërbimeve shëndetësore cilësore do të ndikojë në zbutjen e pabarazive dhe përmirësimin e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre.

Sipas legjislacionit vendor dhe konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e drejta për shëndet nuk kufizohet vetëm në të drejtën e njeriut për kujdes shëndetësor, por përfshinë edhe të gjithë faktorët socio-ekonomikë të nevojshëm për një jetë të shëndetshme. Këta faktorë përfshijnë banimin, qasjen në ushqim, ujë të pijshëm dhe kushte higjieniko-sanitare adekuate; shëndetin dhe sigurinë në punë; dhe, jetesën në një mjedis të pa ndotur. Prandaj, për të përmirësuar shëndetin e grupeve të marginalizuara, duhet të bëhen përpjekje për të përmirësuar edhe këta përcaktues socio-ekonomikë, që është një nga detyrat e strategjisë.

Përveç kufizimeve në lidhje me pjesëmarrjen dhe përfshirjen e tyre në qasje dhe shfrytëzim të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, gjendja shëndetësore e këtyre komuniteteve ndikohet edhe nga kushtet e vështira të jetesës dhe statusi shoqëror. Prandaj është e rëndësishme të kuptohet se gjendja shëndetësore e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve përfshinë më shumë se qasjen në kujdesin shëndetësor apo në ushqim, pasi mvaret nga një numër i madh i faktorëve të mjedisit socio-ekonomik, që janë jashtë kontrollit të një individi, dhe që mund të rezultojë nga një model afatgjatë i diskriminimit dhe përjashtimit socio-ekonomik. Mënyra e të jetuarit, të ardhurat dhe statusi shoqëror mund të ndikojnë në shëndet sikurse edhe rrethanat në të cilat njerëzit lindin, jetojnë dhe punojnë. Këto mund të shpjegojnë pjesërisht pse këto komunitete kanë tendencë të kenë gjendje më të dobët shëndetësore.¹⁰⁴

¹⁰⁴ Breaking the Cycle of Roma Exclusion in the Eastern Balkans, World Bank Group, 2019.

Megjithatë, janë evidentuar vështirësi të shumta të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në qasjen e kufizuar, mos pjesëmarrjen dhe mos përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shërbimet shëndetësore. ndër to numërojmë varfërinë, kushtet socio-ekonomike, largësinë nga objektet e kujdesit shëndetësor të nivelit dytësor dhe tretësor, pamundësinë për pagesë të trajtimit shëndetësor, blerje të barnave, transport, pagesa joformale për punëtorët shëndetësor, mungesën e dokumenteve të identifikimit dhe, si rezultat i këtyre, shfrytëzim të ulët të shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Kujdesi për fëmijët në vitet e para të jetës është një nga mënyrat më efikase dhe më kosto-efektive për të zvogëluar problemet që mund të shfaqen tek fëmijët me status të ulët socio-ekonomik. Pengesë për këtë kujdes paraqet regjistrimi i lindjes për fëmijët nën pesë vjeç në komunitetet Rom dhe Ashkali në Kosovë. Mesatarisht, 9 nga 10 fëmijë janë regjistruar para ditëlindjes së tyre të parë dhe ky proporcion rritet me moshën, pothuajse të gjithë fëmijët janë regjistruar para ditëlindjes së tyre të pestë. Megjithatë, rreth 10% e fëmijëve të lindur në Kosovë, mes romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, janë të regjistruar por nuk kanë certifikatë të lindjes.

Tabela 13. Shkalla e vdekshmërisë tek fëmijët

Vite para studimit	Shkalla e vdekshmërisë neonatale: SDG 3.2.2	Shkalla e vdekshmërisë post-neonatale	Shkalla e vdekshmërisë foshnjore	Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve	Shkalla e vdekshmërisë nën 5 vjeç: SDG 3.2.1
Kosova					
0–4	11	4	15	1	16
5–9	10	4	14	1	14
10–14	19	8	27	2	29
Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë					
0–4	21	5	26	2	27
5–9	12	6	19	3	22
10–14	27	8	34	4	38

(Burimi: Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) për komunitetet Rom dhe Ashkali në Kosovë të realizuar në 2019-2020) ¹⁰⁵

Bazuar në Tabelën 13, është vlerësuar se në Kosovë, mesatarisht vdesin 16 fëmijë nën moshën 5 vjeç për 1,000 lindje. Kjo vlerë është pothuajse dy herë më e lartë në mesin e fëmijëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali, 27 fëmijë vdesin për 1,000 lindje. Gjithashtu, është vlerësuar se 21 fëmijë për 1,000 lindje nga komunitetet Rom dhe Ashkali vdesin brenda muajit të parë të jetës

¹⁰⁵ MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ASK, 2020.

dhe 26 fëmijë për 1.000 lindje vdesin pa i mbushur një vjet. Shkalla e vdekshmërisë për fëmijët e parë të lindur në Kosovë është 23 fëmijë për 1000 lindje.

Shkalla e lindjes së adoleshenteve është 7 herë më e lartë në mesin e vajzave të moshës 15-19 vjeç që jetojnë në familje më të varfër. 1 në 50 gra të moshës 20-24 vjeç ka pasur lindje para moshës 18 vjeç në Kosovë, megjithatë, gjasat që gratë e kësaj moshe të kenë një lindje para moshës 18 vjeç rritet në 1 në 10 nëse jetojnë në familje në indeksin më të varfër të pasurisë kuintil. Në komunitetet Rom dhe Ashkali në Kosovë, 1 në 6 kanë lindur fëmijë të gjallë para moshës 18 vjeç. Gjithsej 73 përqind e fëmijëve të moshës 24–35 muaj në Kosovë kanë marrë të gjitha vaksinat në orarin e imunizimit në çdo kohë para anketës. Vetëm 38 përqind e fëmijëve që jetojnë në komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane janë vaksinuar plotësisht. Vetëm 21.6% e romëve të Kosovës dhe 41.4% e ashkalive të Kosovës janë vaksinuar plotësisht. Pasuria e familjes është e lidhur pozitivisht me vaksinimin e plotë: 4 në 5 fëmijë të moshës 24–35 muajsh që jetojnë në familjet më të pasura në Kosovë janë plotësisht të vaksinuar, krahasuar me 3 në 5 fëmijë që jetojnë në familjet më të varfra. Një model i ngjashëm vërehet tek fëmijët nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane.¹⁰⁶ Megjithatë, përqindja e fëmijëve të pa imunizuar u rrit në pothuajse 50 % gjatë pandemisë. Arsyet kryesore janë: Institucionet shëndetësore ishin të fokusuara në luftimin e COVID 19, ndërjegjësim i ulët i prindërve, kufizimet e lëvizjes dhe lajme të rreme për vaksinat. Shumica e grave në moshë riprodhuese në Kosovë janë vizituar të paktën një herë nga personeli i kualifikuar shëndetësor gjatë shtatzënisë së tyre dhe lindjet janë kryer në ndonjë institucion shëndetësor, ndërsa gjendja e tyre shëndetësore përcillet nga personeli i kualifikuar shëndetësor. Pothuajse të gjitha gratë në popullatën e përgjithshme kanë bërë katër ose më shumë vizita të kujdesit para lindjes nga ndonjë ofrues i shërbimeve shëndetësore, ky ishte rasti për 3 nga 4 gratë nga komunitetet Rom dhe Ashkali. Hendeku ishte më i madh për gratë Romë dhe Ashkallike që jetojnë në zonat rurale.

Rrethanat e sipërpërmendura ndikojnë në jetëgjatësi më të shkurtër të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali, e cila është më e shkurtër se 60 vjet, në krahasim me mesataren e Kosovës prej 70.5 vjet.

Analiza e politikave dhe masave publike në shëndetësi

Mbulimi i ulët i sigurimeve shëndetësore në Kosovë shpjegohet me faktin se në Kosovë, ndryshe nga vendet e tjera, nuk ka sigurim shëndetësor të detyrueshëm, pavarësisht miratimit të ligjit në vitin 2014.¹⁰⁷ Kjo është arsyeja për normat e ulëta të sigurimit shëndetësor të raportuara si tek romët ashtu edhe tek fqinjët e tyre jo rom. Vetëm rreth 10 përqind e secilit grup kanë mbulim të sigurimit shëndetësor. Sipas MICS, 19.2 përqind e grave, 11.1 përqind e burrave dhe 19.3 përqind e fëmijëve rom posedojnë sigurim shëndetësor. Në krahasim me vetëm 0.9 përqind e grave, 6.7 përqind e burrave dhe 0.7 përqind e fëmijëve ashkali të Kosovës.

¹⁰⁶ 2019-2020 MICS in Kosovo & 2019-2020 MICS ëëith Roma, Ashkali and Egyptian communities in Kosovo, UNICEF

¹⁰⁷ Ligji nr. 04/L -249 për sigurimin shëndetësor (Gazeta Zyrtare, nr.29, 30 prill 2014).

Përgjatë pandemisë, në nivele komunale janë ndërmarrë masa reaktive të cilat kanë ndihmuar sadopak komunitetet Rom dhe Ashkali. Ndër masat më të zakonshme janë shpërndarë pako ushqimore dhe higjienike, ku përfshihen gjësende esenciale për mbijetesë, si miell, vaj e produkte të tjera esenciale, si dhe masa mbrojtëse, siç janë dezinfektues, maska, dorëza dhe produkte tjera higjienike¹⁰⁸.

2.4. Banimi

Objektiva Strategjike 4: Rritja e qasjes së barabartë në banim të qëndrueshëm,¹⁰⁹ shërbime esenciale dhe infrastrukturë publike për komunitetet Rom dhe Ashkali

Banimi është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies njerëzore. Banimi ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë dhe është komponentë e rëndësishme e zhvillimit social-ekonomik, gjegjësisht të standardit jetësor. Banimi është e drejtë sociale e qytetarëve në shumicën e vendeve të zhvilluara. E drejta në banim gjithnjë e më shumë është e pranishme në kuadër të politikave globale dhe në luftë për të drejtat njerëzore, e sanksionuar edhe me konventa ndërkombëtare.

Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë janë analizuar modele të ndryshme për zgjidhjen e problemit të banimit, përfshirë programin me qira joprofitabile në banimin social dhe programin e bonus banimit duke subvencionuar nga komuna qiranë e tregut në njësitë e banimit privat. Është ardhur në përfundim se duhet të punohet në evidentimin gjithëpërfshirës të nevojave të pjesëtarëve të komuniteteve për ndihmë në fushën e banimit që do të realizohet përmes bazës së të dhënave që është në zhvillim e sipër. Pastaj, duhet vazhduar me trajtimin e vendbanimeve joformale, si dhe sigurimin e banimit, në kuadër të mundësive buxhetore dhe gatishmërisë së donatorëve për të ndihmuar në këtë fushë.

Për arritjen e Objektives Strategjike 4 teoria e ndryshimit parasheh: 1) që një studim i mirëfilltë i fizibilitetit të banimit për komunitetet Rom dhe Ashkali në komuna të ndryshme përcakton nevojat dhe mundësitë do të përcaktojë hapat konkret që duhet ndjekur për të siguruar zgjidhje të qëndrueshme të banimit për këto komunitete; 2) që vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali për t'u angazhuar aktivisht në zgjidhjen e çështjes së banimit do të rris efikasitetin drejtë zgjidhjeve të qëndrueshme të banimit të tyre; 3) që përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe investimi në infrastruktura përcjellëse do të përmirësojnë komoditetin dhe cilësinë e jetës dhe qasjen në shërbime esenciale; 4) që ndërgjegjësimi i stafit publik të programeve të banimit rreth trajtimit të barabartë dhe luftimit të diskriminimit, do të ndikojnë në qasje të barabartë dhe përmirësimin e shërbimeve të banimit që pranojnë pjesëtarët e

¹⁰⁸ The Challenges of the Roma, Ashkali, Egyptian Community in Kosovo During the Covid-19 Pandemic, Admovere, July, 2020.

¹⁰⁹ Shërbimet esenciale përfshijnë qasje në ujësjellës, kanalizim, shërbime të mbledhjes dhe menaxhimit të mbeturinave, rrymë elektrike, qasje në transport dhe shërbime financiare, si dhe komunikim digjital

komuniteteve Rom dhe Ashkali; dhe 5) që përmes revidimit të planeve ekzistuese urbanistike dhe atyre të reja që të përfshijnë konkretisht çështjet e banimit të komuniteteve Rom dhe Ashkali, si dhe ofrimit të alternativave cilësore të banimit për këto komunitete, do të arrihen zgjidhje të qëndrueshme të banimit në çdo komunë.

Për të arritur Objektiven Strategjike 4, janë paraparë këto Objektiva Specifike:

4.1 Objektiva Specifike 1: Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe përcaktimi i hapave konkret për të përmirësuar sistematikisht gjendjen e banimit për komunitetet Rom dhe Ashkali;

4.2 Objektiva Specifike 2: Vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali në zgjidhjen e problemeve të banimit;

4.3 Objektiva Specifike 3: Ngritja e komoditetit dhe cilësisë së jetës së komuniteteve Rom dhe Ashkali përmes përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese si dhe infrastrukturës përcjellëse për qasje më të mirë në shërbime esenciale;

4.4 Objektivat Specifike 4: Qasja e barabartë dhe përmirësimi i shërbimeve cilësore të banimit ndaj komuniteteve Rom dhe Ashkali, përmes ndërgjegjësimit të stafit publik përgjegjës për programet e banimit;

4.5 Objektiva Specifike 5: Formalizimi i vendbanimeve joformale të komuniteteve Rom dhe Ashkali përmes revidimit të planeve ekzistuese urbanistike dhe përfshirjes konkrete në planet e reja urbanistike si dhe ofrimit të alternativave për riorganizimin e vendbanimeve ekzistuese.

4.6 Objektiva Specifike 6: Qasja e barabartë në shërbime esenciale, përfshirë ujin, kanalizimin, shërbimet e mbledhjes së mbeturinave, dhe luftimi i segregimit hapësinor si shkak i diskriminimit mjedisor në fushën e banimit.

Banimi si një e drejtë sociale e qytetarëve në shumicën e vendeve të zhvilluara, gjithnjë e më shumë është e pranishme në kuadër të politikave globale dhe në luftë për të drejtat njerëzore, e sanksionuar edhe me konventa ndërkombëtare, dhe e mbështetur ligjërisht edhe në Kosovë, ka ende punë për arritjen e zgjidhjes afatgjate për banim të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës.

Romët dhe ashkalitë kanë po ashtu probleme të banimit dhe nevoja për sigurimin e banimit vazhdon të jetë shumë më e madhe sesa mundësitë buxhetore.

Kushtet e banimit të komuniteteve Rom dhe Ashkali, dhe atyre të popullatës së përgjithshme kanë dallime substanciale në Kosovë. Pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali jetojnë në vendbanime dhe shtëpi pa infrastrukturë thelbësore dhe adekuate, duke përfshirë qasje të rregullt në ujë të pijshëm/rjedhshëm, energji elektrike dhe pajisje të tjera themelore. Për më tepër, sfidat

pasojnë në shumë aspekte të tilla si legalizimi i shtëpive apo banesave të tyre, zgjidhjet afatshkurtër dhe të papërshtatshme të banimit, dëbimet e detyruara dhe të ngjashme.

Vlen të ceket se banimi vazhdon të mbetet problem i madh i komuniteteve Rom dhe Ashkali, për të cilin nuk ka zgjidhje të lehtë dhe të shpejtë. Madhësia mesatare e ekonomisë familjare në Kosovë është 4.9 anëtarë. Në Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, madhësia mesatare e ekonomisë familjare është 5.8 anëtarë.¹¹⁰

Një numër i konsiderueshëm i familjeve Rom dhe Ashkali nuk posedojnë dokumente të kompletuara që vërtetojnë pronësinë ligjore të banimit dhe tokës së tyre. Për shkak të kushteve jo adekuate të jetesës, shqetësimet janë të shumta dhe prioritetet kategorizohen në përputhje me rrethanat. Statusi i papërcaktuar ligjor i komunitetit rom, dëbimet e dhunshme, burokracitë dhe diskriminimi ka çuar në shumë sfida dhe bashkë me të shpesh herë neglizhenca e qëllimshme për të tentuar procedurat e legalizimit të banimit të tyre. Kjo ka vazhduar me breza të tërë, gjë që tani paraqet sfida të re për shkak të dokumenteve të pakompletuara. Prandaj, kjo situatë shton më shumë procedura, punë në administratë dhe kosto potencialisht gjithashtu, gjë që i dekurajon fillimin e procesit të legalizimit.

Kushtet e banimit të komuniteteve Rom dhe Ashkali konsiderohen të jenë nën standardet minimale të cilësisë, gjithashtu vështirësi të theksuara në qasje në shërbime. Për më tepër, banimi është nën normat minimale të njësisë së banimit dhe numri i anëtarëve të familjeve është i madh, kështu që kjo çon në mbipopullim. Sipas një raporti nga Banka Botërore (2019), banesa mesatare e banuar nga një familje romë në Ballkanin Perëndimor ka tendencë të ketë 2.0 deri në 2.5 dhoma, ndërsa në bazë ekonomike, numri i dhomave për person midis romëve varion nga 0.5 dhe 0.8¹¹¹. I njëjti raport thekson jetesën e familjeve romë në banime me vetëm një dhomë, ku nga e gjithë popullata romë, 16% janë regjistruar t'i përkasin kësaj kategorie në Kosovë.

Vendbanimet romë janë kryesisht semi-urbane dhe urbane, por gjithashtu edhe rurale. Përveç masave të nivelit qendror dhe atij lokal në lidhje me banimin e romëve, nevojat e tyre për banim plotësohen edhe nga donatorët ndërkombëtarë.

Disa nga sfidat kryesore në lidhje me banimin e komuniteteve Rom dhe Ashkali janë:

1. Statusi i pazgjidhur i pronësisë ligjore mbi tokën dhe njësitë e banimit;
2. Përfshirja e pamjaftueshme dhe e pabarabartë e pjesëtarëve të komuniteteve në programet institucionale të banimit zgjidhjen e problemit të banimit;
3. Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme të shërbimeve komunale dhe shërbime të tjera të nevojshme dhe adekuate në vendbanimet romë dhe të ashkalive;
4. Cilësia e dobët ndërtimit të njësisë ekzistuese të banimit, mungesa e sigurisë së tyre fizike dhe komoditeti i ulët;
5. Niveli i lartë i varfërisë që ndikon që çmimet e pronës dhe patundshmërisë të bëhen vazhdimisht më të papërballueshme;

¹¹⁰ Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ASK, 2020.

¹¹¹ World Bank, 2019: Breaking the Cycle of Roma Exclusion in the Eastern Balkans.

6. Hapësirat e limituara të familjeve që vazhdimisht janë në zgjerim përmes gjeneratave të reja dhe krijojnë nevojën për strehimin e një numri në rritje të familjeve;
7. Vështirësitë e çështjeve me ndarjen e tokës/gjetjen e zgjidhjeve të strehimit për të kthyerit dhe personat e riatdhesuar.

Analiza e politikave dhe masave publike në banim

Buxheti i Qeverisë së Kosovës, i cili ndahet për të siguruar banim, është mjaftë i vogël. Përveç tjerash deri më tani nuk ka pasur një vijë buxhetore të veçantë për banim në nivel komunal për fushën e banimit e as për komunitetet Rom dhe Ashkali. Në përputhje me nenin 25 të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit,¹¹² komunat duhet të hartojnë programet trevjeçare të banimit dhe pas miratimit në Kuvendet Komunale, mund të kërkojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës përmes MMPHI përkrahje financiare për ndërtimin e ndërtesave për banim social. Këto programe trevjeçare duhet të paraqesin numrin e kërkesave që kanë nevojave për banim duke u përfshirë edhe komunitetet Rom dhe Ashkali, sigurimin e zonave për ndërtim dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, administrimin e kërkesave për banim dhe mirëmbajtjen e njësive të banimit me qira. Gjithashtu sipas ligjit duhet të caktojë zyrtari për banimi në kuadër organizimit dhe mënyrën e funksionimit për zbatimin e politikave të banimit në Komunë.

Deri tani, nevojat e komuniteteve për banim janë plotësuar kryesisht nëpërmjet financimit ndërkombëtar të donatorëve. Megjithatë, në vitin 2018 Qeveria ndau 2.4 milion Euro për të ndërtuar banesa sociale për komunitetet Rom dhe Ashkali dhe komunitetet tjera të marginalizuara,¹¹³ projekt ky i cili ende nuk ka përfunduar.

Përveç fondeve për ndërtimin e njësive të banimit, është edhe mungesa e të dhënave për adresimin e këtyre nevojave në nivel komunal,¹¹⁴ që vazhdon të jetë ende sfidë. Si rrjedhojë ka mos përputhje të strategjive apo planeve/aktiviteteve nga akterët e involvuar, siç janë donatorët e jashtëm apo të brendshëm me institucionet relevante që ndikon drejtpërdrejtë në plotësimin e nevojave më urgjente apo strategjive afatgjata.

¹¹² Ligji nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit (Gazeta Zyrtare, nr. 67, 29 mars 2010).

¹¹³ Dokument Pune i Personelit të Komisionit Evropjan, Komunikata për Politikën e Zgjerimit të BE-së, 2019.

¹¹⁴ Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare, 2017-2021, Prill, 2017.

2.5. Diskriminimi

Objektiva Strategjike 5: Parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, segregimit, paragjyqimeve, stereotipeve, dhe bullizmit

Luftimi dhe parandalimi i diskriminimit ndaj romëve (lexo: dhe ashkalive) sipas Kornizës së BE-së për Përfshirjen e Romëve, përfshin numrin e personave që në situatë shoqërore janë ndier të diskriminuar për shkak të përkatësisë së tyre etnike (lexo: rom apo ashkali). Po sipas kësaj Kornize, në këto raste, duhet ndërmarrë masa për luftimin e diskriminimit, ngacmimit, krimet të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes kundër pjesëtarëve të komunitetit rom (lexo: dhe ashkali), si dhe promovimin e ndërgjegjësimit të historisë, kulturës, njohjes dhe pajtimit të këtyre komuniteteve.

Diskriminimi në bazë të etnisë për komunitetet Rom dhe Ashkali është shkaktar i shumëfishtë i problemeve të këtyre komuniteteve dhe konsiderohet hendek kryesor i integritit të këtyre komuniteteve në shoqëri dhe ekonomi. Për shkak se diskriminimi, është një nga shkaktarët kryesor në pothuajse të gjitha sferat e jetës sociale dhe ekonomike të komuniteteve Rom dhe Ashkali, kjo strategji parasheh mekanizma specifik në qasjen drejt luftimit të tyre.

Njëherit, secila Objektivë Strategjike (Arsimi, Punësimi dhe Mirëqenia Sociale, Shëndetësia dhe Banimi) posedon objektivë specifike që lufton diskriminimin në nivelin e synimeve të objektivës strategjike. Në shumicën e rasteve objektivat specifike relevante duhet të shtjellojnë dhe zbatojnë ndërgjegjësimin e akterëve relevantë mbi rëndësinë e luftimit e diskriminimit si dhe promovimit të historisë dhe kulturës së komuniteteve Rom dhe Ashkali. Në nivelin e objektivave specifike këto angazhime të ndërgjegjësimit janë të specifikuara për fushën relevante (p.sh. në arsim me profesionistë, nxënës dhe prindër, në shëndetësi drejtuar punëtorëve shëndetësor dhe punës relevante me pacientë, etj.).

Në anën tjetër, çështja e luftimit të diskriminimit, ngacmimit, krimet dhe gjuhës së urrejtjes ndaj pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali është edhe prioritet strategjik në vete, që kërkon trajtim të veçantë dhe konkret në nivel më të lartë. Regjistrimi i lindjes dhe shtetësisë paraqet të drejtën elementare civile në jetën e pjesëtarëve të komuniteteve e cila u mundëson qasjen në të drejta dhe shërbime të shtjelluara me këtë strategji. Megjithatë, përbrenda komuniteteve ende ekzistojnë persona lindja e të cilëve nuk është evidentuar në regjistrat e gjendjes civile si pasojë e disa faktorëve objektiv edhe subjektiv. Krijimi i instrumenteve dhe mekanizmave që adresojnë këtë fushë strategjike si të veçuar janë të shtjelluara në vijim, përmes objektivave specifike të Objektivit Strategjik 5.

Për arritjen e Objektivës Strategjike 5, teoria e ndryshimit parasheh: 1) që me zhvillimin dhe zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse në të gjithë fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve do të ndikojë në luftimin e racizmit dhe diskriminimit ndaj komuniteteve Rom dhe Ashkali në mënyrë sistematike; 2) që zhvillimi dhe aprovimi i propozimit legjislativ për barazi, pjesëmarrje, përfshirje dhe luftimin e diskriminimit dhe racizmit, do të ndikojë në mënyrë sistematike dhe në rritjen e cilësisë së jetës për komunitetet Rom dhe Ashkali; 3) që ndërgjegjësimi

i komuniteteve Rom dhe Ashkali për rëndësinë dhe mënyrën e raportimit të rasteve të racizmit dhe diskriminimit do të rritet numri i rasteve të raportuara dhe kështu institucionet relevante do të mund të ndër marrim masa disiplinore ndaj ushtruesve të diskriminimit dhe kështu të ngrisin llogaridhënien ndaj komuniteteve të synuara dhe objektivave strategjike; 4) që vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi i publikut dhe zyrtarëve publikë për racizëm dhe diskriminim ndaj komuniteteve Rom dhe Ashkali ndikon në rritjen e tolerancës dhe përfshirjes dhe integritit të këtyre komuniteteve në shoqëri dhe ekonomi; dhe 5) që ndërgjegjësimi dhe promovimi i historisë dhe kulturës së komuniteteve Rom dhe Ashkali në publik, arsim dhe shërbim civil/ administratë publike ndikon në rritjen e tolerancës dhe përfshirjen dhe përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqëri dhe ekonomi.

Për të arritur Objektiven Strategjike 5, janë paraparë këto Objektiva Specifike:

5.1 Objektiva Specifike 1: Luftimi i diskriminimit dhe racizmit në mënyrë sistematike përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve;

5.2 Objektiva Specifike 2: Ulja e dukurisë së racizmit dhe diskriminimit dhe rritja e cilësisë së jetës për komunitetet Rom dhe Ashkali në mënyrë sistematike përmes zhvillimit të propozimit legjislativ për barazi, pjesëmarrje, përfshirje dhe luftimit të racizmit dhe diskriminimit;

5.3 Objektiva Specifike 3: Rritja e llogaridhënies dhe ndëshkimit ndaj ushtruesve të diskriminimit dhe ndërgjegjësimi i pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali për rëndësinë dhe mënyrën e raportimit të rasteve të diskriminimit, racizmit, ngacmimit, gjuhës dhe dhunës së urrejtjes dhe bullizmit;

5.4 Objektiva Specifike 4: Rritja e përfshirjes së komuniteteve Rom dhe Ashkali përmes vetëdijesimit dhe ndërgjegjësimit të publikut dhe zyrtarëve publik për racizëm dhe antidiskriminim ndaj komuniteteve Rom dhe Ashkali si dhe promovimit të historisë dhe kulturave të komuniteteve Rom dhe Ashkali.

5.5 Objektiva Specifike 5: Mbështetja dhe avancimi i punës së Grupit Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të themeluar nga Qeveria, për të adresuar ankesat nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për diskriminim ndaj tyre, si dhe për të realizuar aktivitetet për vetëdijesimin e publikut për parandalimin e diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Republika e Kosovës ka krijuar një kornizë ligjore të avancuar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve të bazuar në politika dhe standarde ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë për të gjitha komunitetet. Në këtë drejtim, edhe objektivat strategjike të kësaj Strategjie duhet t'i shikojmë nga prizmi i zbatimit praktik të këtij legjislacioni, si dhe standardet më të avancuara ndërkombëtare.

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare zbatohet direkt në Kosovë me përfshirjen e saj në Kushtetutë. Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve promovon frymën e paqes, tolerancës, dialogut ndërkulturor dhe ndër-fetar dhe

mbështet pajtimin mes komuniteteve. Standardet e përcaktuara në këtë ligj, në Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe në instrumentet e tjera relevante respektohen, në mënyrë që ta arrijë barazinë e plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Kosovës. Në Nenin 9.2 të këtij ligji posaçërisht u referohet komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptase, ku ndër të tjera përcaktohet: "...Konsiderim i veçantë i kushtohet përmirësimit të gjendjes së komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian." Ndërsa, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹¹⁵ përcakton kornizën e përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë. Ky ligj është shumë i rëndësishëm për komunitetet Rom dhe Ashkali. Neni 24.1 i Kushtetutës përcakton që të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.¹¹⁶ Në lidhje me këtë nen të Kushtetutës, duhet pasur parasysh Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, i cili zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës.¹¹⁷ Ndërsa, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit, duhet të veprojnë në përputhje me parimet e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.¹¹⁸ Po ashtu, duhet pasur parasysh që, çdo person mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, kur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka kryer një akt diskriminues në kuptimin e këtij ligji. Përgjegjësia individuale nuk e përjashton përgjegjësinë e institucioneve shtetërore ose të personit juridik privat.¹¹⁹

Pra, Republika e Kosovës duhet të sigurojë, në baza jo diskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrorjnë të drejtat e tyre, të specifikuara me Kushtetutë,¹²⁰ si dhe duhet të sigurojë kushte të duhura, të cilat ua mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre.¹²¹ Në këtë drejtim,

¹¹⁵ Ligji nr. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi (Gazeta Zyrtare, Nr. 16, 26 qershor 2015) <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924&langid=1>

¹¹⁶ Në lidhje me nenin 24 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese (Rasti KI 55/17 (70)) konsideron se kjo nënkupton që parimet e përgjithshme të barazisë se trajtimit zbatohen për të gjitha veprimet e autoriteteve publike në marrëdhëniet e tyre me individët, dhe të gjitha autoritetet publike në procedurat e tyre duhet të garantojnë mbrojtjen e barabartë të drejtave të individëve.

¹¹⁷ Ligji nr. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi (GZ, Nr. 16, 26 qershor 2015), Neni 2.

¹¹⁸ Ligji nr. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi (GZ, Nr. 16, 26 qershor 2015), Neni 8.

¹¹⁹ Po aty, Neni 12.

¹²⁰ Kushtetuta, Shih Neni 58.7

¹²¹ Po aty, Neni 58

Republika e Kosovës duhet të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t'u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar.¹²²

Një rëndësi të veçantë për mbrojtjen e gjuhës romë ka edhe Ligji për përdorimin e gjuhëve.¹²³ Përveç këtyre ligjeve, Republika e Kosovës gjithashtu ka edhe mekanizma të tjera mbështetëse të gjithë përfshirjes dhe kundër diskriminimit.

Diskriminimi, stigmatizimi, gjuha e urrejtjes, dhuna e urrejtjes, bullizmi, paragjykimi dhe perceptimet e gabuara për romët dhe ashkalitë ende mbizotërojnë në Kosovë si në vendet e tjera të Evropës. Këto, "...përbëjnë shkaqet kryesore për përjashtimin social të këtyre komuniteteve, ndërsa efektet e situatës së tyre janë të dukshme në papunësinë e lartë, përqindjen e ulët të regjistrimit dhe arritjeve në arsim dhe kushtet e mjerueshme të jetesës së shumicës së këtyre komuniteteve."¹²⁴

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë më së shumti të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës paragjykuese dhe "vazhdojnë të jenë në grupet më të cenueshme dhe të diskriminuara në Kosovë. Sipas raporteve vëzhguese, edhe gjuha e urrejtjes kundër komuniteteve Rom dhe Ashkali është rritur në një numër të mediave dhe portaleve online".¹²⁵

Lidhur me gjuhën e urrejtjes, në vitin 2014/2015 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) shqyrtoi dhe gjykoj gjithsej 91 akuza për gjuhë të urrejtjes kundër komunitetit rom në internet media të cilat janë dorëzuar nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.¹²⁶ Megjithatë, nuk ka pasur regjistrime zyrtare të ankesave ndaj gjuhës së urrejtjes në sistemin gjyqësor.

Nga të dhënat e MICS e vitit 2020, të fokusuar edhe për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas raportohet se 13% e vajzave dhe 16% e djemve të këtyre komuniteteve të moshave 15-19 vite janë ndier të diskriminuar për shkak të prejardhjes së tyre etnike. Për krahasim, vlerat për tërë Kosovën për këto grup moshë janë 2% tek vajzat dhe 3% tek djemtë.¹²⁷ Theks të veçantë duhet t'i vihet diskriminimit të vajzave dhe grave nga komunitetet Rom dhe Ashkali, meqenëse, 1 në 10 vajza në tërë Kosovën janë shprehur se janë diskriminuar në bazë të gjinisë, pra ky fenomen që prek gjithë popullsinë i bën edhe më të cenueshme gratë dhe vajzat e komuniteteve Rom dhe Ashkali, që vuajnë nga diskriminimet e shumëfishta.

¹²² Po aty, Neni 58.3 Gjykata Kushtetuese (Rasti K012/18 (115)) rikujton që "...trajtimi është diskriminues nëse një individ trajtohet ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Gjykata Kushtetuese përsërit se trajtimi i ndryshëm duhet të ndjekë një qëllim legjitim për të qenë i justifikuar dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet."

¹²³ Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve (Gazeta Zyrtare, nr. 10, 01 mars 2007) <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440&langid=1>

¹²⁴ The Fall of Antigypsism – Civil Rights Defenders (CRD, 2017).

¹²⁵ Raporti për Kosovën, Civil Rights Defenders (CRD, 2016).

¹²⁶ Iniciativa e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut

¹²⁷ Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian, UNDP 2020.

III. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT TË STRATEGJISË

Procesi i zbatimit të Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali për vitin 2022-2026, do të jetë një proces i realizimit të synimeve strategjike dhe objektivave të saj. Si rrjedhojë edhe synimi kryesor i institucioneve të Republikës së Kosovës, pa dyshim se është zbatimi në tërësi i Strategjisë, proces ky që do të paraprihet nga realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite.

Për zbatimin e objektivave strategjike, është hartuar Plani i Veprimit tre (3) vjeçar (2022-2024) në të cilat përcaktohen objektivat specifike, aktivitetet konkrete karshi institucioneve përgjegjëse dhe mbështetëse për zbatimin e tyre, treguesit SMART, gjendja ekzistuese, synimi/targeti, burimet financiare, të cilat janë përlogaritur duke iu referuar buxhetit të paraparë në kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH) si dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre. Gjithashtu, në përlogaritjen e nevojave financiare janë merr në konsideratë edhe projektet me financim nga donatorët, në vijim ose të planifikuara, sipas fushave specifike.

Të gjitha institucionet qeveritare, qendrore dhe lokale, në përputhje me përgjegjësitë dhe mandatin ligjor të tyre, obligohen të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin të detyrimeve të përcaktuara në Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali për vitin 2022-2026 dhe si rrjedhojë edhe të Planit Veprimit 2022-2024. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe monitorimit të zbatimit të Planeve Lokale të Veprimit (PLV), siç është përcaktuar në Kapitullin VI (Korniza e zbatimit, monitorimit dhe raportimit në nivel komunal), të kësaj Strategjie.

Zyra për Qeverisje të Mirë është e mandatuar që të realizoj monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali për vitin 2022-2026

Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e Strategjisë dhe komponentë kryesorë të procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e Strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimitet e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga ZQM në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesit.

Monitorimi do të jetë proces kyç për ofrimin e informatave të nevojshme për qëllime llogaridhënieje, ai nuk do të jetë efektiv nëse nuk ndërmerren veprime ndaj asaj që është vlerësuar dhe raportuar. Andaj, çdo vit mekanizmat përgjegjës duhet të hartojnë raportin vjetor, i cili duhet

të përmbajë vlerësimin e aktiviteteve më të suksesshme, raportimin mbi indikatorët e performancës dhe në përgjithësi përmbushjen e qëllimeve të strategjisë, identifikimin e sfidave dhe vështirësive të hasura gjatë procesit të zbatimit si dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete për mënjanimin e pengesave të paraqitura përgjatë procesit të përmbushjes së objektivave specifike dhe atyre strategjike.

Për monitorimin e zbatimit të dokumentit strategjikë dhe efektivitetit të saj janë esenciale:

- i. për të siguruar që po arrihen qëllimet,
- ii. për të monitoruar kontributet e investuara dhe aktivitetet,
- iii. për të siguruar nëse zbatimi po shkon sipas rrjedhës së përcaktuar,
- iv. për të paralajmëruar institucionet përgjegjëse për problemet/ngecjet ose problemet potenciale para se situata të bëhet kritike,
- v. për të sugjeruar veprime korigjuese ose për të rishikuar strategjinë në bazë të përvojës së fituar.

Duke monitoruar strategjinë dhe indikatorët e performancës, institucionet do të jenë në gjendje të krijojnë një pasqyrë mbi gjendjen, d.m.th. ku ndodhet Strategjia drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara, nxjerrjes së mësimave, marrjes së masave korigjuese, dhe nëse është e mundur, proceseve rishyqrtuese të saj. Praktikantët më të mira theksojnë se vlerësimi është më i dobishëm kur nxirren mësim nga procesi i zhvilluar, të cilat pastaj shfrytëzohen për procese në të ardhmen. Prandaj, gjatë vlerësimit të efektivitetit të Strategjisë një gjë të tillë duhet pasur parasysh. Në këtë kuptim, Plani i Veprimit por edhe Strategjia sipas nevojë do të jetë një dokument dinamik, që do t'i përshtatet ndryshimit të objektivave, rrethanave dhe përvojës së fituar.

Rishikimet e progresit dhe nevojave potenciale për revidime mund të ndodhin në çdo periudhë të raportimit, ndërsa një vlerësim i detyrueshëm i tillë dhe më i tërthortë i progresit dhe nevojave për revidim planifikohet të ndodh me përfundimin e vitit të tretë (2024) të strategjisë, ku duhet të përcaktohen edhe synimet dhe specifikat për aktivitetet dhe treguesit për dy vitet e mbetura.

- **Caktimi i zyrtarit përkatës për raportim për zbatimin e Strategjisë**

Ministritë dhe komunat, sipas specifikave të fushë veprimtarisë së tyre, me qëllim të koordinimit të zbatimit dhe raportimit të kësaj Strategjie caktojnë zyrtarin përkatës për raportim në ZQM.

Zyrtari përkatës për koordinim, monitorim dhe raportim të zbatimit të Strategjisë, në kuadër të ministrive dhe komunave, është përgjegjës për bashkëpunim me ZQM dhe të bënë monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë nëpër vite duke përfshirë edhe PLV.

ZQM koordinon dhe udhëzon zyrtarët përkatës për mënyrën e raportimit të Strategjisë.

Zyrtari përkatës për koordinim dhe raportim paraqet në ZQM raport për zbatimin e Strategjisë çdo vit, sipas formatit të përcaktuar nga ZQM, dhe gjithashtu sipas nevojave dhe kërkesave harton raporte të veçanta për zbatimin e saj.

Të gjithë zyrtarët në kuadër të ministrive dhe komunave janë të obliguar të bashkëpunojnë dhe t'i bashkërendojnë aktivitetet e tyre me zyrtarin përkatës për koordinim dhe raportim të zbatimit të Strategjisë.

I gjithë monitorimi dhe raportimi mbi progresin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, duhet të kalojë përmes Zyrtari përkatës të komunës apo ministrisë përkatëse. Nëse ZQM/ministrinë e linjës kërkojnë informacion shtesë, kërkesa do t'i drejtohet Zyrtari përkatës i komunës gjegjësisht ministrisë, i cili mbledh informacionin e nevojshëm nga institucionet përgjegjëse komunale dhe i raporton ZQM/ministrinë së linjës.

Zyrtari përkatës në komunë për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimit dhe PLV-së shoqëruese, ka detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në pajtim me Kapitullin VI të kësaj Strategjie. Ndërsa, Zyrtari përkatës në ministri caktohet me vendim të Sekretarit. Ministrat sigurojnë që të ndahet buxheti adekuat për zbatimin e Planit të Veprimit, në mbështetje të objektivave të parapara në këtë Strategji dhe aktivitetet e përfshira në Plan Veprimi. Zyrtari përkatës në ministri vepron si zyrtar përgjegjës në ministri për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimit, dhe përfshin funksionet e mëposhtme:

- i. Sigurimi i bashkërendimit të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të midis strukturave të ministrisë;
- ii. Sigurimi i koordinimit të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit me ministrinë e linjës dhe ZQM;
- iii. Vepron si pikë e kontaktit për ministrinë përkatëse dhe ZQM për çështjet që kanë të bëjnë me Strategjinë dhe Planin e Veprimit dhe situatën e komuniteteve Rom dhe Ashkali, në fushëveprimin e ministrisë;
- iv. Përpilimi i raporteve vjetore për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe pas miratimit të këtyre raporteve nga ministri i dërgon raportet në ZQM;
- v. Verifikimi i informacioneve të raportuara.

Zyrtari përkatës në ministri duhet të jetë punonjës i njësive përkatëse që kanë të bëjnë me objektivat strategjike të kësaj Strategjie.

ZQM mund të propozojë ndryshimin e termave të referencës për Zyrtarët përkatës të komunës dhe ministrive, duke përcaktuar përgjegjësitë e këtyre mekanizmave, në pajtim me këtë Strategji dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

ZQM organizojë punëtori periodike për ngritjen e kapaciteteve për Zyrtarët përkatës të komunës dhe ministrive për të shqyrtuar zbatimin e kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimit duke përfshirë edhe zbatimin e PVL-së.

Konsolidon të dhënat për zbatim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit dhe PLV;

ZQM organizon takimi sektoriale çdo tre muaj me zyrtarët përkatës nga Ministria dhe me shoqërinë civile për të koordinuar, rishikuar diskutuar zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit.

Organizon takime vjetore me zyrtarët përkatës për të rishikuar zbatimin.

- **Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë**

Çdo vit, progresi drejt zbatimit të përgjithshëm të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të nivelit qendror, si dhe PLV, do të vlerësohet duke matur shkallën në të cilën janë arritur objektivat e përcaktuara për aktivitete specifike. Rëndësia e aktiviteteve të parashikuara në PLV gjithashtu do të rishikohet në dritën e ndryshimit të rrethanave në komunë, dhe PLV ndryshohet nëse lind nevoja.

Vlerësimi do të bazohet në kriteret e mëposhtme:

- i. Efektiviteti në përmbushjen e objektivave të përcaktuara;
- ii. Relevanca në aspektin e përgjigjes ndaj nevojave aktuale të komuniteteve Rom dhe Ashkali në komunë;
- iii. Qëndrueshmëria në kuptimin e krijimit të një ndryshimi të qëndrueshëm të sjelljes ose ndryshimit të praktikave institucionale;
- iv. Proceset në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën e përcaktuar nga kjo Strategji dhe Termat e Referencës përkatëse.

- **Përfshirja e çështjeve gjinore dhe rinisë**

Të gjithë akterët përgjegjës duhet të sigurojnë që situatat dhe perspektiva e ndryshme të grave dhe burrave, si dhe personave të grup moshave të ndryshme, me theks të veçantë tek të rinjtë (p.sh., gratë dhe burrat e moshës 15 deri në 24 vjeç) të përfshihen në të gjitha fazat e procesit të zbatimit, monitorimit, vlerësimit dhe raportimit. Kjo duhet të reflektohet, në veçanti, në procesin e hartimit të PLV-së, dhe në përpilimin e raporteve narrative.

- **Korniza e zbatimit, monitorimit dhe raportimit në nivel komunal**

Zbatimi i Objektivave Strategjike të Strategjisë, në nivel komunal, është një prej elementeve kryesore, siç është monitorimi dhe raportimi adekuat për zbatimin në nivel komunal dhe koordinimin vertikal midis Qeverisë dhe institucioneve të nivelit komunal. Struktura efektive institucionale është e një rëndësie vendimtare. Kjo Strategji dhe Plani i Veprimit parashikon një

sërë aktiviteteve që do të zbatohen në nivel komunal drejtpërdrejtë nga ministritë e linjës në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me udhëheqjen komunale.

Për të arritur qëllimin e zbatimit, monitorimit, vlerësimit dhe raportimit efektiv në nivel komunal, Strategjia parasheh një sërë masash që do të zbatohen në të gjitha komunat me një popullsi më të madhe të komuniteteve Rom dhe Ashkali. Komunat me popullsi më të vogël të komuniteteve Rom dhe Ashkali inkurajohen të zbatojnë të njëjtat masa, ose të sigurojnë që vëmendje e plotë t'i kushtohet zbatimit të Strategjisë dhe nevojat e komuniteteve Rom dhe Ashkali, si dhe të përfshihen në hartimin e politikave komunale përmes masave tjera.

Masat e parashikuara janë si në vijim:

1) Komitetet Komunale të Veprimit (KKV) të themeluara për Strategjinë e periudhës 2017 – 2021 do të mbahen dhe nëse është e nevojshme, do të krijohen edhe në komunat tjera. Anëtarësimi në KKV do të ndryshohet për të lejuar:

- i. Pjesëmarrja e të gjitha organizatave aktive joqeveritare që punojnë me komunitetet Rom dhe Ashkali në komunë;
- ii. Përfaqësimi i departamenteve/drejtorive të linjës me nga një zyrtar, nëse drejtori nuk është i disponueshëm;
- iii. Përfaqësim më i gjerë i palëve relevante komunale, veçanërisht në fushën e punësimit dhe shëndetësisë.

Inkurajohet roli aktiv i kryetarit të komunës, nënkryetarit ose nënkryetarit të komunës për komunitete në KKV.

KKV do të përbëhen nga përfaqësues nga: ZKKK-ët, drejtorja përkatëse e linjës (Arsimi; Mirëqenia Sociale dhe Shëndeti; Strehimi), drejtorja së financave, qendra se punësimit, Qendra për Punë Sociale, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), zyrtari përkatës komunal për barazi gjinore, zyrtari përkatës komunal për të drejtat e njeriut. Gjithashtu pjesë e KKV-së do të jenë të gjitha organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare ose donatorët që mbështesin projektet që synojnë komunitetet Rom dhe Ashkali në komunën përkatëse.

Përgjegjësia kryesore e KKV-së është hartimi i Planit Lokal të Veprimit (PLV) dhe ndryshimi periodik i tij nëse lind nevoja. Në zhvillimin dhe ndryshimin e PLV-së, KKV-ja do të sigurojë bashkërendimin ndërmjet palëve të ndryshme të interesit dhe qasjen e të gjithë hisedarëve.

KKV do të themelohet me vendim të Kryetarit të Komunës në afat prej 60 ditësh nga data e miratimit të kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimit.

2) Planet Lokale të Veprimit (PLV) të hartohen për secilën komunë. KKV-ja duhet të udhëheqë hartimin e PLV, dhe pasi të përfundojë, PVL duhet të miratohet nga Komiteti Komunal për Komuniteteve (KKK), Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe në fund Kuvendi Komunal.

- i. Buxheti adekuat duhet të ndahet për zbatimin e PLV;
- ii. Gratë dhe burrat e grup moshave të ndryshme, me theks të veçantë të rinjtë (d.m.th., gratë dhe burrat e moshës ndërmjet 15 dhe 24 vjeç), persona që vijnë grupe të ndryshme socio-ekonomike që i përkasin komuniteteve rome dhe ashkali duhet të konsultohen në procesin e hartimit të PLV;
- iii. PLV duhet të pasqyrojë nevojat specifike të grave dhe burrave me prejardhje të ndryshme socio-ekonomike dhe të grup moshave të ndryshme, me një theks të veçantë të rinjtë (d.m.th., gratë dhe burrat e moshës 15 deri në 24 vjeç), që i përkasin secilit komunitet, dhe t'i kushtojë vëmendje rrethanave të ndryshme në pjesë të ndryshme të komunës, aty ku është e aplikueshme;
- iv. PLV do të pasqyrojë objektivat dhe aktivitetet e parashikuara në këtë Strategji dhe Plan Veprimi, dhe më tej do të marrë parasysh nevojat dhe përparësitë specifike vendore, dhe do të parashikojë aktivitete në nivel lokal.
